# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7593 E enjte 19 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga SORINA KOTI

## Konsolidimi i funksioneve të reja të pushtetit vendor



Konsolidimi i funksioneve shtesë, që iu kaluan bashkive për shkak të zbatimit të Reformës Administrative Territoriale dhe decentralizimit financiar, shihet ...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

## Amerika, Gjermania dhe ndarja ideologjike

Presidenti Donald Trump i shtoi kritikat ndaj kancelares gjermane, Angela Merkel, duke thënë në një intervistë televizive se politikat e saj të emigracionit ...

Vijon në faqen 21



Presidentja nderon martirët e luftës me serbët

# Kolinda Kitaroviç: 87 të vrarë, mirënjohje shqiptarëve që ranë për lirinë e Kroacisë

Ilir Meta: Kroacia mbështetëse e fortë e jona në BE. Së shpejti do jemi partnerë strategjikë

DARINA TANUSHI

Presidenti shqiptar, Ilir Meta priti dje homologen kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç. Në një konferencë të përbashkët për mediat, Presidenti Meta u shpreh se vlerëson mbështetjen e Kroacisë për çeljen e negociatave ...

Në faqen 3

AGJENCIA E PRONAVE ÇEL APLIKIMET, DOREZIMI I DOSJEVE NIS ME 23 KORRIK

# KOMPENSIMI, 370 PRONARET QE NDAJNE 74 MILIONE LEKE

Gjashtë dokumentet dhe formulari TIP për t'u dorëzuar në ATP. Emrat e përfituesve të fondit në të gjithë vendin, që iu është zënë toka nga ndërtimet informale



*(Në foto)* Ndërtime pa leje (foto ilustruese)

Në faqen 10

DEBATI NE KOMISION

## Bushati: Nuk ka rishikim kufijsh me Greqinë, por pakt për piramidat

Në faqen 2

PRESIDENTI I SHBA

## Trump: Malazezët dhe shqiptarët mund të ndezin Luftën III Botërore

Në faqen 12

SI MERRET PRONESIA

## Qeveria: Ndërtimet para vitit 1991, procedura e re për të përfituar tapinë

Në faqen 6

"SUMMER PAGES"

## Enxhi Çuku: Në Shqipëri është shumë e vështirë që të jesh artiste

Suplement

ZV/KRYEMINISTRJA NE SHBA



## Senida Mesi në OKB: "Axhenda 2030" në linjë të plotë me integrimin e vendit

Në faqen 5

Shkodër/ Elvis Hoxha në gjykatë: Nuk jam unë autori, kam qenë te dajat

# Vrau shokun me kallash, 17-vjeçari mohon krimin

*Pas arrestimit e pranoi krimin: U zumë për një kapele, më rrahu, e qëllova*

Nga SENAD NIKSHIQI

SHKODËr-Gjyqi ndaj të akuzuarit për vrasjen e 23-vjeçarit Hermes Beqiri në Shkodër ka marrë një rrjedhë tjetër. Autori i dyshuar, Elvis Hoxha ka ndryshuar dëshminë e tij para trupit gjykues. Ai ka deklaruar në seancën e djeshme gjyqësore se nuk është ai autori i vrasjes dhe se nuk ka qenë aty në momentin kur ka ndodhur krimi. Ndërkohë që më herët ai kishte pranuar se e vrau me breshëri kallashnikovi Beqirin, pas një sherri për një kapele ...



Në faqen 8

# NEGOCIATAT
## DEBATET

### Debate në Komisionin e Jashtëm, ministri: Klima e mirë ndihmon integrimin

# Negociatat me BE, Shehu: Nuk u hapën, të ikë qeveria. Bushati: Jemi në rrugën e duhur

### *Negociatat me Greqinë: Tri marrëveshje për ndarjen e detit e tokës*

Deputetët e opozitës i kërkuan dje dorëheqjen ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, por edhe të gjithë qeverisë me argumentin se iu ra pika kryesore e programit, hapja e negociatave me Bashkimin Evropian. Seanca dëgjimore e ministrit të Jashtëm në Komisionin e Politikës së Jashtme u shoqërua dje me debate. "A mund të qëndrojë kjo qeveri, ky kryeministër dhe ju në krye të vendit pasi ju ra flamuri, pika kryesore e programit dhe aspirata e madhe e Shqipërisë", u shpreh deputeti i PD-së, Tritan Shehu. Sipas Shehut, qeveria po bën propagandë dhe Shqipëria ende nuk e ka një datë për negociatat. Ndërsa ministri Bushati iu përgjigj: "Meqë përmendët shtratin e negociatave, po mendoj që kjo ëndrra që ju ngadalësohet duhet të ishte një stil prej rilindasi në PD". Bushati tha më tej se Shqipëria është në rrugën e duhur, por procesi është i vështirë dhe sfidues. "Një klimë më mirë kuptuese politike veçse e ndihmon përparimin e Shqipërisë në këtë proces. Negociatat janë në horizontin e 2019-ës. Hahn përcaktoi edhe afatin për hapjen e kapitujve të parë negociues", u shpreh Bushati. Komisioni u përfshi në debate dhe këmbëngulja e nënkryetarit Tritan Shehu për të marrë fjalën për procedurë dhe refuzimi i kryetares Mimi Kodheli për ta lejuar të flasë solli ndërprerjen e seancës dëgjimore. Ky moment nga demokratët u lexua si tentativë për t'i mbyllur gojën opozitës dhe frikë e mazhorancës për t'u përballur me argumente. Në fjalën e tij në komision, ministri Bushati u shpreh: "Sa i përket konceptit të negociatave, kemi një bazë të mirë, janë dy apo tri projekte të asistencës së BE-së, që kanë punuar me ekspertët e ish-Ministrisë së Integrimit Evropian dhe natyrisht që pak a shumë modelet konvergojnë të gjitha në një pikë ku do të ketë një delegacion shtetëror, që do të udhëhiqet nga ministri i Jashtëm. Do të ketë një ekip për procesin e 'screening', që më pas do të transformohet edhe në ekipin negociator të këtij procesi shumë të rëndësishëm". Ministri Bushati u ndal edhe te konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian.

**MARRËVESHJA ME GREQINË**

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati sqaroi pas raportimit në Komisionin e Jashtëm gazetarët për negociatat me Greqinë. Bushati deklaroi se nuk ka marrëveshje për ndryshim kufijsh, por për një proces teknik për mirëmbajtjen e tyre. "Kemi një draftmarrëveshje në diskutim sa i përket kufizimit të zonave detare të kemi dy projektmarrëveshje në diskutim për piramidat dhe menaximin e incidenteve kufitare. Me tri projektmarrëveshjet e mbyllim të gjithë çështjen që është në diskutim sa i përket detit dhe tokës", u shpreh Bushati. Ministri th se Presidenti Meta e ka dhënë autorizimin dhe se me dosjen voluminoze po merren ekspertët. "Presidenti për çështjen e marrëveshjes për kufizimin e zonave detare ka lëshuar një autorizim për ministrin e Jashtëm, ndërsa ministri i Jashtëm ka përgatitur aktin e plotfuqisë dhe delegacioni shtetëror përfaqëson mendimet e Republikës së Shqipërisë", tha ai. Sa u takon përplasjeve brenda grupit të negociatorëve, Bushati pohoi se, "është krejt normale që në një grup të madh siç është grupi i ekspertëve shqiptarë të këtë diskutime, ka një dosje super voluminoze në Ministrinë e Europës dhe Punëve të Jashtme, mbi 1000 faqe, që është produkt i ekspertëve. Për çështje të ndryshme ka pasur gjithmonë opsione nga më të ndryshme. Por ju garantoj që në tryezën e bisedimeve, jo për këtë proces, por për çdo proces tjetër të ngjashëm, Shqipëria flet me një zë siç imponon ligji". Ai tha se opozita po dizinformon publikun. "Ka shumë dizinformim, sidomos nga PD. Flitet për km katrorë det, për zona potencialisht naftëmbajtëse, për fshirje të nocionit të çështjes çame. Është e qartë që ka një tentativë të orkestruar për ta mbajtur këtë marrëdhënie në tension. Jemi të vendosur për ta mbajtur këtë deri në një. Kemi një plus në raport me Greqinë, kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese që na thotë qartë çfarë s'duhet të bëjmë. I kemi qëndruar konform këtij vendimi. S'duhet ta ushqejmë opinionin publik me iluzione. Greqia s'ka humbur asnjë luftë me ne, as ne me ata", deklaroi Bushati. Ministri nuk preferoi të japë afate, ndryshe nga çfarë ka deklaruar komisioneri Hahn se negociatat me Greqinë do të mbyllen brenda dy javësh.



Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati në Komisionin e Politikës së Jashtme

**KLAJDA GJOSHA**

"Frika tashmë nga e vërteta dhe për t'u përballuar si me anëtarët e opozitës dhe me të vërtetën besoj që është e dukshme për qytetarët dhe nuk është normale. T'i mashtrosh ata që negociatat janë çelur, kur jo vetëm nuk janë çelur, por Shqipëria duhet të kalojë në kushte të përcaktuara qartë nga konkluzionet e Këshillit Europian", tha dje ish-ministrja e LSI-së, Gjosha në Komisionin e Jashtëm.



Presidenti shqiptar, Ilir Meta dje me homologen kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç

**KUFIRI DETAR**

"Kemi një draftmarrëveshje në diskutim sa i përket kufizimit të zonave detare dhe kemi dy propjektmarrëveshje në diskutim për piramidat dhe menaxhimin e incidenteve kufitare. Me tre projektmarrëveshjet e mbyllim të gjithë çështjen që është në diskutim sa i përket detit dhe tokës"

### Kryetarja e Komisionit të Jashtëm: Më shumë rezultate, nëse Majko do jetë ministër vitin tjetër

# Opozita, kritika për punën me diasporën. Majko hesht, Kodheli "humor" me ministrin



Komisioni parlamentar për Punët e Jashtme miratoi dje projektrezolutën "Për reformën e politikës shtetërore për diasporën". Projektrezoluta vinte në komision si dokument i hartuar me propozim të nënkomisionit parlamentar të Diasporës. I pranishëm në mbledhjen e sotme të Komisionit për Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko u gjend përballë kritikave se nuk është bërë asgjë për diasporën. Kryetarja e komisionit, Mimi Kodheli e vlerësoi projektrezolutën si moment të veçantë dhe një prej arritjeve më të mira në proceset integruese dhe shtetformuese në raport me diasporën. "I një rëndësie krejt të veçantë, që bashkon përgjegjësitë e shtetit shqiptar dhe përgjegjësitë e çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë me bashkëkombësit e vetë jashtë atdheut, për t'u dhënë atyre më shumë të drejta në përfaqësimin e tyre, mënyrën si ata mund të japin votëbesimin për forca të caktuara politike", u shpreh znj. Kodheli lidhur me projektrezolutën. Deputetja demokrate, Rudina Hajdari, e vetmja përfaqësuese e opozitës që ishte e pranishme në seancën dëgjimore me ministrin Majko në Komisionin e Jashtëm, u shpreh se puna e kësaj ministrie është e papërfillshme dhe nuk ka realizuar asnjë nga pritshmëritë. Ministri Majko nuk iu përgjigj, ndërsa kryetarja e komisionit, Mimi Kodheli me nota humori u shpreh se këtë vit do të ketë më shumë rezultate nëse Majko do të jetë ende në detyrë. "Diaspora ka nevojë të bashkëpunojë më shumë me qeverinë shqiptare. E shikoj këtë vit si një vit që nuk është bërë asgjë", tha Rudina Hjadari. Ndërsa Kodheli u shpreh: "Pa dyshim që ndaj të njëjtin mendim me zonjën Hajdari. Do të vijë një vit më prapa, uroj që ministër të jetë po zoti Pandi". Ministri Majko në fjalën e tij vuri në dukje problemet me të cilat përballet diaspora shqiptare, si problemi i pashtetësisë apo vota e diasporës. "Ne nuk mund të hedhim asnjë sa i përket të drejtës së votës së shtetasve pa votën e opozitës. Ky është një vendim që në fund fare do t'i takojë Komisionit të Reformës Zgjedhore".

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kitaroviç në Tiranë, pritet nga Meta: Shqiptarët, të mirëpritur për punësim sezonal

# Presidentja e Kroacisë: Mirënjohje, 87 shqiptarë dhanë jetën në luftën për liri

## Meta: Së shpejti do të jemi partnerë strategjikë

Darina Tanushi

Presidenti shqiptar, Ilir Meta priti dje homol ogen kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç. Në një konferencë të përbashkët për mediat, Presidenti Meta u shpreh se vlerëson mbështetjen e Kroacisë për çeljen e negociatave. "Kroacia ka qenë mbështetëse e çeljes së negociatave, pasi ndajmë vizion dhe interesa të përbashkëta. Mirënjohje për projektin e kombeve të bashkuara mbi menaxhimin e ujërave detare. Patëm kënaqësinë të mirëprisimin njoftimin e Avranopulos sot në lidhje me Kosovën", u shpreh dje Presidenti Meta. "Modeli dhe eksperienca e Kroacisë në BE është shumë e vyer për ne shqiptarët. Po kështu, si dy vende anëtare në NATO, ne ndajmë vizion dhe interesa të përbashkëta edhe në fushën e sigurisë dhe për këtë kemi një bashkëpunim shumë të mirë e të konsiderueshëm dhe që do ta shtojmë akoma më tej në të gjitha aspektet. Dy vendet po punojnë që së shpejti ta ngrenë nivelin e bashkëpunimit, në atë të 'partneritetit strategjik'", tha më tej kreu i shtetit shqiptar. Nga ana e saj, presidentja kroate vlerësoi shqiptarët si miq të vërtetë, duke u shprehur se në këtë periudhë në Kroaci kërkohen mjaft punonjës sezonalë. "Bisedat sot ishin shumë miqësore. Shpreh besimin dhe shpresën se ne do të vazhdojmë këtë dialog dhe diskutuam për bashkëpunimin. Shqipëria ishte mkja jonë gjatë kohës kur miqtë ishin të pakët. Shqipëria na ka mbështetur gjatë kohës që ne luftonim për lirinë e kombit tonë. Nga 18 mijë shqiptarët që jetojnë në Kroaci, 2.500 ishin vullnetarë në luftën e Kroacisë, 87 humbën jetën 37 janë të zhdukur. Kjo është një çështje shumë e madhe për ne dhe u jemi mirënjohës shqiptarëve që luftuan për lirinë e vendin tonë. Minoriteti shqiptar në Kroaci është një shembull i përfaqësimit të minoritetit në shoqëri", u shpreh presidentja kroate. "Kërkojmë të punësojmë punëtorë sezonalë dhe shqiptarët janë mëse të mikpritur. Jam gjithashtu shumë e kënaqur mbi marrëveshjen e ndotjes detare mbi detin Adriatik. Ka mbështetjen tonë teknike në rrugën drejt BE-së. Jemi gati të vazhdojmë jo vetëm mbështetjen politike, por çfarëdo që keni nevojë", u shpreh më tej presidentja kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç. I pyetur nga gazetarët sa u përket negociatave me Greqinë dhe vetingun, Presidenti Meta u shpreh: "Për çështjen e negociatave theksoj angazhimin tim të plotë. Është e rëndësishme të kuptojmë që është një proces që duhet të barazohet me barazinë e palëve. Nga ana ime si president, iu siguroj që do të bëj gjithçka për të përmbushur detyrimet e mia. Sa për vetingun, ajo është reformë madhore. Shpreh mbështetjen time. Ju siguroj për përmbushjen e detyrimeve. Dua të theksoj edhe rëndësinë e bashkëpunimit midis qeverisë dhe opozitës".



Presidenti Ilir Meta me homologen kroate, Kolinda Grabar-Kitaroviç

**NDERIMI**

Presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitaroviç u shpall dje "Qytetare Nderi" e qytetit të Beratit. Këshilli bashkiak i këtij qyteti miratoi dje dhënien e titullit "Qytetare Nderi" Presidentes së Kroacisë, Kolinda Grabar Kitaroviç. Ajo do të mbajë sot një fjalë edhe në Parlamentin shqiptar, ndërsa ka takime edhe me kreun e PD-së si dhe kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

## Veliaj: Besoj te presidenti

### Ligji për teatrin e ri, Meta: S'do ndikohem nga asnjë faktor

Presidenti Ilir Meta u përcolli dje mesazhin e qartë si mazhornacës, ashtu edhe opozitës se nuk do të ndikohet nga asnjë faktor i jashtëm për dekretimin ose jo të ligjit për Teatrin Kombëtar. Kur kanë mbetur edhe 12 ditë kohë në dispozicion të kreut të shtetit për dekretimin, refuzimin ose lënien në fuqi me heshtje për ligjin e Teatrit Kombëtar, vetë presidenti duket se nuk ka asnjë nxitim për ta thënë fjalën e fundit më parë. I pyetur dje nga mediat për këtë çështje, presidenti Ilir Meta tha se ende po shqyrton ligjin dhe që vendimi i tij nuk do të ndikohet nga asnjë faktor i jashtëm. Z.Meta është shprehur se vendimi i presidentit nuk do të ndikohet nga asnjë faktor i jashtëm, por nuk dha një përgjigje nëse do ta dekretojë apo jo ligjin. "Do të mbaj qëndrim për aq sa kam përgjegjësi. Dua t'ju siguroj që në çdo vendim nuk do të ndikohem nga asnjë faktor jashtë përgjegjësive që ka presidenti. Nuk do të veproj jashtë përgjegjësive të mia", deklaroi Presidenti Meta. Gjendur në një tryezë, fill pas fjalës së presidentit, kryetari i bashkisë, Erion Veliaj ka zgjedhur shprehjen e kreut të shtetit, duke thënë së është i bindur se do të triumfojë dashuria dhe qetësia, duke i dhënë udhë ndërtimit të teatrit të ri. Veliaj theksoi se beson te Presidenti Meta se do ta dekretojë ligjin. "Unë shpresoj te Presidenti si institucion, por edhe si person. Ilir Meta është një njeri jashtëzakonisht konstruktiv, që gjithmonë ka synuar paqe sociale, jo sherr, jo shamatë. Besoj që qetësia e dashuria do triumfojnë, për diçka që për të cilën tashmë besoj se ka konsensus publik, konsensus të gjerë publik tek aktorët, tek ata që votuan në parlament dhe tek popullata, sepse siç e tha i madhi Robert Ndrenika, kemi nevojë për teatër e jo për muze. Ndaj, për një teatër të ri besoj do gjendet një vullnet i mirë, kam shumë besim", u shpreh Veliaj.



Qeveria miraton masat disiplinore për ata që kapen nga Task Forca

## Rama: Do publikoj me emër punonjësit që abuzojnë me shërbimin ndaj qytetarëve

Kryeministri Edi Rama kërkoi ndëshkim për të gjithë ata punonjës të hipotekave që kanë abuzuar me shërbimet ndaj qytetarëve. Në takimin e përjavshëm me koordinatorët e bashkëqeverisjes me qytetarët, Rama tha se, "pavarësisht skepticizmit të natyrshëm dhe mosbesimit të krijuar me vite të tëra, si rezultat i shumë nismave të lëna rrugës nga qeveritë e mëparshme, për të krijuar një raport të drejtpërdrejtë me qytetarët, besimi tek platforma po rritet, numri i qytetarëve që i drejtohen platformës po rritet dhe hallet dhe problemet që zgjidhen po rriten në numër". Duke iu referuar dëshmive të ardhurave, kryeministri u shpreh: "Me një gur vrasim dy zogj, zgjidhim një hall, adresojmë një problem, por nga ana tjetër identifikojmë punonjësit në zyrat e shtetit që meritojnë t'iu tërhiqet veshi kur kanë gabuar pak, apo të ndëshkohen administrativisht dhe të largohen nga puna kur kanë gabuar shumë, apo të shkojnë në ndjekje penale, kur nuk bëhet fjalë për një gabim, por bëhet fjalë për një faj që ndëshkohet nga ligji". Rama njoftoi edhe vendimin e marrë në mbledhjen e qeverisë për raportin e masave ndëshkimore. Ai paralajmëroi se, "raportin e masave ndëshkimore do ta bëjë me emër dhe mbiemër për çdo punonjës që është shkaktar i këtyre situatave. Task-forca e antikorrupsionit që drejtohet nga ministrja e Drejtësisë po bën një punë voluminoze. Nuk është e lehtë! Paralelisht me platformën ka një proces auditimesh dhe hetimesh administrative të befasishme në të gjithë territorin e organizmit institucional të vendit. Raportet e masave tanimë po konsolidohen dhe kur të jenë plotësisht të konsoliduara, do të bëhen transparente për publikun", njoftoi kryeministri. Në mbledhjen e djeshme të qeverisë u miratuan edhe disa shtesa në ligjin për nëpunësin civil, sa i përket vlerësimit për marrjen e masës disiplinore, kur punonjësi kapet në shkelje.



Kryeministri Edi Rama

# TEATRI I RI
## DEBATI

### Tabaku, Shkrelit: Fol për teatrin, siç fole për kangjellat e Kryeministrisë

# PD: Qeveria i thirri mendjes, u tërhoq nga ligji për teatrin

### *Korrupsioni, Ndreu: Lista e zezë e Ramës ishte gabim*


Presidenti Ilir Meta dje në aktivitetin "Aleanca për Dhurimin e Gjakut"

Valentina Madani

Kuvendi mbyll punimet më 23 korrik, një javë para përfundimit të afatit të dekretit të presidentit. Këtë fakt, deputetët e opozitës e shikojnë si tërheqje të qeverisë për ligjin e teatrit, pa llogaritur që në çdo moment, kreu i Kuvendit ka të drejtën të thërrasë parlamentin në seancë të jashtëzakonshme. Më 5 korrik mazhoranca miratoi me 75 vota ligjin për Teatrin Kombëtar, pas 12 orë diskutimesh. Por, shembja e godinës së vjetër dhe ndërtimi i tetarit të ri pritet që këtë të enjte të jetë pjesë e debateve në seancë plenare. Partia Demokratike, me anë të deputetes demokrate Jorida Tabaku, në Komisionin e Ekonomisë, deklaroi dje se qeveria është tërhequr nga ligji për Teatrin Kombëtar. Kjo, sepse sipas PD-së, mbyllja e sesionit parlamentar pa pritur dekretin e Presidentit Meta është tërheqje. Më tej, Tabaku i bëri thirrje zv.ministrit në qeverinë Rama, Artan Shkreli që të flasë për teatrin. Në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë, Tabaku tha se si një "mbrojtës i trashëgimisë kulturore", Shkreli duhet të flasë për godinën simbol të trashëgimisë kulturore në Shqipëri. "Zoti Shkreli, në qoftë se keni diçka për të komentuar, unë besoj që është rasti që të flasësh edhe për teatrin. Dole për kangjellat e Kryeministrisë, mendoj se ka ardhur dita se si një adhurues i trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar, të dalësh dhe të flasësh për teatrin. Përdore edhe këtë komision se ne këtu kemi folur gjatë për teatrin. Në qoftë se ke dëshirë, unë besoj që kryetari ta jep hapësirën që të flasësh për teatrin", iu drejtua Jorida Tabaku zv.ministrit në Komisionin e Ekonomisë.

**DEBATI**

Një vit pasi Edi Rama botoi listën e tij të zezë me 100 zyrtarët më të korruptuar sipas tij, socialistët pranojnë se ishte një gabim i kryeministrit. Lista u botua në 12 korrik 2017, duke hapur shumë debate, por debati u zhvendos në Komisionin e Ekonomisë, aty ku u paraqit për të mbrojtur një projektligj edhe drejtori i Hekurudhave. Ani Dyrmishi ishte në listën e Edi Ramës i 28-ti, kur asokohe mbante detyrën e drejtorit të Hipotekës në Durrës. "Shoh këtu një person, Ani Dyrmishi, është i ftuar. Me një kërkim në 'Google', më rezulton që të jetë shpallur nga kryeministri Rama ndër 100 zyrtarët më të korruptuar. Tani, nëse e marrim për standard Ramën, çfarë bën ky person sot në parlament?", tha Tabaku. Deklarata nxehu tonet mes socialistëve, që menjëherë u hodhën në mbrojtje. Socialistja Evis Kushi u kundërpërgjigj: "Për çfarë e ka nxjerrë, moj, për çfarë?". Por Tabaku replikoi: "Nuk e di moj, nuk e di, kryeministri e ka nxjerrë, atij i referohem". Socialisti Pjerin Ndreu pati guximin të pohojë se ai ishte një gabim i kryeministrit. "Duhet të kemi kujdes kur i referohemi informacioneve, jo të gjitha informacionet janë fakte. Kryeministri ka marrë përsipër të bëjë një publikim të tillë, për mua ka qenë një gabim dhe ju e dini, aty ka pasur edhe raste të tjera flagrante", tha z.Ndreu. Blerina Gjylameti ndërhyri duke thënë: "Nuk jemi në bankën e të akuzuarit që t'i kërkojmë z. Dyrmishi të deklarohet nëse është fajtor apo i pafajshëm". Vetë Dyrmishi nuk foli, por zëvendësministri Artan Shkreli i bëri mbrojtjen përpara këtij debati të papritur. Artan Shkreli, zv.ministër i Infrastrukturës: "Edhe unë jam akuzuar nga Berisha si i korruptuar, po duhet të jemi seriozë, ky nuk është vendi". Dyrmishi e Shkreli ishin në Komisionin e Ekonomisë për projektligjin që i hap rrugë riparimit të hekurudhës Tiranë-Durrës dhe ndërtimit të aksit të ri hekurudhor, Tiranë-Rinas.


Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku

**AKUZA**

Deputeti demokrat, Florion Mima tha dje se qeveria po pastron paratë e krimit nëpërmjet 3 aktiviteteve: "Rritja e numrit të lejeve të ndërtimit është gati 300%. Tregon që ka një presion për ta rritur këtë aktivitet. Aktiviteti i dytë janë lojërat e fatit. Sot numërohen rreth 4000, por do këtë edhe të tjera që s'janë deklaruar. Po ashtu, edhe aktivitetet që qeveria përpiqet t'i largojë nga taksat. Se kështu shmangin prezencën e organeve hetuese".

### Teatri, PD: Mashtrimi i Ramës, kompania nuk është pronare kufitare

PD apeloi dje kreun e shtetit, Ilir Meta të mos dekretojë ligjin për teatrin. PD i bëri thirrje dhe prokurorisë që të nisë një hetim, pasi sipas Albana Vokshit, qeveria ka gënjyer kur ka thënë se kompania që po e ndërton është pronar kufitar me pronën e teatrit. Sipas PD-së, kompania ka në pronësi vetëm 298 metra katrorë dhe jokufitare me teatrin. "Edi Rama dhe kukullat e tij, Veliaj e Kumbaro kanë gënjyer qëllimisht Kuvendin. Kjo është një arsye e mjaftueshme që presidenti të mos e dekretojë ligjin korruptiv. Mashtrimi i Parlamentit me ligj nga kryeministri është një fakt i mjaftueshëm, që çdo prokurori e pavarur dhe e pakontrolluar politikisht do të merrte sot në ndjekje penale Edi Ramën dhe çdokënd që ka mbrojtur këtë mashtrim skandaloz, duke përfshirë Erion Veliajn dhe Mirela Kumbaron", tha zj.Vokshi. Më 5 korrik, mazhoranca miratoi me 75 vota ligjin për Teatrin Kombëtar pas 12 orë diskutimesh. Por shembja e godinës së vjetër dhe ndërtimi i tetarit të ri pritet që këtë të enjte të jetë pjesë e debateve në seancë plenare.

### Punësimet, Braçe kërkon borderotë. Mima: Vendi po shkon drejt skamjes

Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë devijoi dje nga programi duke u përqendruar në debatin për punësimin. Deputeti i PD-së, Florion Mima, akuzon qeverinë se po e rrit varfërinë në vend me hapa të frikshëm. "Opozita gjithnjë kryen një punë të mirë, pasi ka krimbin e dyshimit. Kur ne kemi ikur nga pushteti kanë qenë 450 mijë vetë të punësuar në sektorin privat jobujqësor, por janë shtuar 300 mijë thotë qeveria. I bie që të ardhurat të rriteshin me gjysmat e tyre, rritja është 3-4%, pra ka tregues që të bëjnë të dyshosh. Besoj që ekonomia shqiptare është në prag recensioni, jo në prag të krize, por të një stanjacioni. Kjo sjell rritje të fukarallëkut, të skamjes, Varfëria po rritet me hapa të frikshëm", tha Mima. Nënkryetarja Jorida Tabaku tha se shifrat e publikuara nuk janë të vërteta, pasi nëse do kishte rritje të të punësuarve, atëherë do rriteshin edhe të ardhurat në buxhet. Tabaku u shpreh se zyrat e punës janë inekzistente. Ndërkohë, zv.ministrja e Financave e kundërshtoi këtë argument duke prezantuar shifrat e punësuarve në muajt e fundit. Dajna Sorensen, zv.ministre e Financave dhe Ekonomisë deklaroi: "Në muajin paraardhës numri i personave të punësuar nëpërmjet zyrave të punës në Shqipëri ka qenë 3591. Një muaj më parë ka qenë 3434, një muaj më përpara ka qenë 2796. Ne kemi dyfishin e vendeve të lira të punës aktive në këtë moment krahasuar me numrin e personave që punësojmë. Për të mbyllur debatin, kreu i Komisionit të Ekonomisë i kërkoi Ministrisë së Financave që të sjellë borderotë e të punësuarve. "Të vijë e gjithë lista e borderove. Borderotë e 2013-ës dhe ato të tanishme. Sillini, ose bëjini ju publike, me qëllim të kuptohen njerëzit", deklaroi z.Braçe. Komisioni miratoi tri marrëveshje midis të cilave edhe marrëveshja e BERZH, për financimin e projektit "Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë-Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës".




**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date **10.08.2018 ora 8°° - 16°°** ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II per shitjen e pasurise te paluajtshme Truall me sipërfaqe 24,405.50 m² e ndodhur në rrugën "Ali Shefqeti", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, Volumi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë BAU- CONSTRUCTION sh.p.k me vlere fillestare ne ankand 341,676.72 (Treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) EURO .

**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 24.07.2018, Ora 16:000**

**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Enkelea Novaku dhe dorëzanësit Adriatik Novaku:
"Truall" me sipërfaqe 100 m2 dhe "Ndërtesë" me 3 kate me sipërfaqe 90 m2 secili, 2 kate të miratuara me Vendim për Leje Ndërtimi Nr. 22 datë 29.04.1996 të Këshillit Bashkiak Pogradec, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 10 400 000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

**"Toke Are me sip 865 m2 , me Nr pasurie 131|86 Zona kadastrale nr 1896 , Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .**

**2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 302,400 (Treqind e dymije e katerqind ) Lekë .**

Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date **27.07.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,



Zv/kryeministrja në SHBA prezanton raportin kombëtar: Angazhim gjithëpërfshirës

# Senida Mesi në OKB: "Axhenda 2030" në një linjë me integrimin

## Takimi me kreun e UNDP: Bashkëpunim i frytshëm

Zv.kryeministrja e Shqipërisë, Senida Mesi prezantoi në Nju Jork raportin kombëtar të rrugëtimit të vendit drejt arritjes së objektivave universale të OKB-së, njohur ndryshe si "Axhenda 2030", axhendë e cila përbën një angazhim universal të miratuar me konsensus nga të gjitha vendet anëtare të OKB-së që në vitin 2015-të, me anë të së cilës synohet ndërmarrja e veprimeve konkrete, me qëllim çrrënjosjen e varfërisë, mbrojtjen e planetit, sigurimin e barazisë gjinore dhe garantimin që çdo popull të gëzojë paqe e prosperitet. Në prezantimin e saj, zv.kryeministrja Mesi nënvizoi faktin se raporti vullnetar i Shqipërisë është reflektim i një angazhimi gjithëpërfshirës i aktorëve të ndryshëm dhe është bazuar në një proces të mirëintegruar. Në lidhje me masat që vendi ynë ka ndërmarrë për arritjen e këtyre objektivave universale, znj. Mesi nënvizoi faktin se vendi ynë i ka dedikuar sinergji të madhe kombëtare, duke filluar me punën e Komitetit Ndër-Ministerial, që zbaton dhe monitoron strategjitë kombëtare në lidhje me objektivat; aprovimin unanim në parlament të rezolutës për avancimin e tyre; nënshkrimin vitin e kaluar nga 25 universitete publike e private të një marrëveshjeje mirëkuptimi në drejtim të një roli më aktiv të tyrin. Gjatë vizitës së saj në SHBA, Mesi u takua me administratorin e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), z. Achim Steiner, me të cilin diskutoi mbi bashkëpunimin e gjatë dhe kontributin e dhënë deri tani për Shqipërinë. "Gjatë takimit, i bëra me dije z. Steiner progresin e bërë deri më tani nga vendi ynë, në kuadër të reformave të ndërmarra dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Së bashku me z. Steiner, diskutuam gjithashtu për mundësitë e reja që do të na çojnë drejt një bashkëpunimi të vazhdueshëm e të frytshëm", u shpreh Mesi në "FB".




Zv.kryeministrja e Shqipërisë, Senida Mesi dje në Nju Jork

**INTEGRIMI**

Raporti vullnetar i Shqipërisë është reflektim i një angazhimi gjithëpërfshirës i aktorëve të ndryshëm dhe është bazuar në një proces të mirëintegruar. Në lidhje me masat që vendi ynë ka ndërmarrë për arritjen e këtyre objektivave universale, znj. Mesi nënvizoi faktin se vendi ynë i ka dedikuar sinergji të madhe kombëtare, duke filluar me punën e Komitetit Ndër-Ministerial, që zbaton dhe monitoron strategjitë kombëtare në lidhje me objektivat

### Shkarkimi i Thanzës dhe Ndrecës, Berisha: Po bëhet gjueti shtrigash ndaj veriorëve

Ish-kryeministri Sali Berisha mori dje në mbrojtje dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, Tom Ndreca dhe Admir Thanza, të cilët u shkarkuan dy ditë më parë nga KPK. Berisha shprehet se procesi i vetingut ka degraduar publikisht në një proces që zhvillohet në tërësi me ndonjë përjashtim rastësor, me listë dhe si hakmarrje primitive dhe gjueti shtrigash e në shenjën e urrejtjes të Edvin Kristaq Ramës. Urrejtjes ndaj origjinës nga veriu apo asaj klasore të vetuarve. "Më këto akte që përmbysën Kushtetutën dhe vetë rendin kushtetues të vendit, reforma e drejtësisë e realizoi qëllimin e saj sorosjan, shndërrimin e drejtësisë në Shqipëri, në degë të ekzekutivit të Edvin Kristaq Ramës. Ndaj dhe sot kriminelët e mbarë Shqipërisë, vrasësit, plaçkitësit, përdhunuesit, trafikantët, narkopolicët, narkodrejtorët, narkoçakejtë e narkoqeverisë, narkoministrat me në krye kreun, Edvinin, brohorasin me eufori të papërmbajtur 'Rroftë reforma, poshtë drejtësia'!", shprehet z.Berisha.



Suedi Sverige

INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**
**NJOFTIM TENDERI**

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289"", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqsuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: *Bid 2: "Pajisje pë Qendrën e trajnimit, AC and system mbrojtje nga zjarri":*

- Lot 2: Fire Detection System;
- Lot 3: Projector;
- Lot 4: HDD, TV, WebKonf

Dokumentat e tenderit mund ti gjeni në adresën: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ : nga data **11.07.2018**.
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **26.07.2018**, ora **10:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë.
Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/:
Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në ditën e fundit për dorëzimin e ofertave.

Suedi Sverige

INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

**INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA**
**TENDER NOTIFICATION**

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for Bid 2: "Training centre equipment, AC and fire protection"

- Lot 2: Fire Detection System;
- Lot 3: Projector;
- Lot 4: HDD, TV, WebKonf,

in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.
The tender dossier is available at http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ : from **July 11, 2018.**
The deadline for submission of tenders is: **July 26, 2018,** time **10:00** hrs, at Institute of Statistics of Albania, Blv. "Zhan D'Ark", No. 3, Tirana, Albania.
Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/ .
Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.

## Qeveria miraton rregullat për kalimin e pronësisë për ndërtesën dhe truallin

# Ndërtimet para vitit 1991, procedura e re për të marrë tapinë

## *E drejta e pronës, deri në 300 metra katrorë*

Ornela Manjani



Foto ilustruese

Personat që kanë ndërtuar para vitit 1991 dhe që nuk kanë dokument pronësie si për ndërtesën, ashtu edhe për truallin do të pajisen me tapi. Këshilli i Ministrave miratoi dje vendimin që i hap rrugë nisjes së procedurave, të cilat do të ndiqen nga AULIZNI për pajisjen me dokument pronësie të këtyre pronave. Sipas vendimit, mësohet se ndërtimet e ngritura deri më 10.8.1991 dhe trojet funksionale të tyre, për të cilat nuk ka akte të fitimit të pronësisë do të pajisen me tapi. Vetëm nëse për truallin ka dokumentacion pronësie, procedurat e kalimit të pronësisë kryhen vetëm për ndërtesën. Vendimi përcakton se do të konsiderohen objekt i trajtimit të këtij vendimi ato ndërtime: a) të cilave u mungon akti i fitimit të pronësisë; b) të cilat, nga pikëpamja ndërtimore janë të përfunduara, me mure dhe me mbulesë; c) të cilat nuk janë ndërtime pa leje, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të nenit 3, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Ndërsa truall funksional konsiderohet sipërfaqja e tokës nën ndërtesë, së bashku me oborrin përreth saj, që posedohet efektivisht nga subjekti kërkues. ALUIZNI është institucioni i autorizuar për kryerjen e procedurave administrative, sipas këtij vendimi. Kalimi i pronësisë së ndërtimit dhe truallit funksional për sipërfaqet deri në 300 metra katrorë kryhet pa pagesë, nëpërmjet dokumentit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi.

**PROCEDURAT DHE AFATET**

Procedurat e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi fillojnë: a) me kërkesë të subjektit/subjekteve, sipas modelit të kërkesës të miratuar me këtë vendim, pavarësisht nëse zona kadastrale i është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistematik; b) gjatë procesit të regjistrimit fillestar apo përmirësimit/përditësimit të zonës kadastrale. Në këtë rast, me kërkesë të regjistruesit apo të çdo subjekti të ngarkuar nga kryeregjistruesi, njoftohet ALUIZNI për verifikimin e kushteve dhe vendimmarrjen, sipas këtij vendimi; c) me kërkesë të institucionit shtetëror, në rastet e shpronësimit për shkak të zbatimit të projekteve publike, pavarësisht nëse zona kadastrale i është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistematik. Në vendim përcaktohet se ALUIZNI evidenton në terren ndërtimin dhe truallin funksional, duke verifikuar paraprakisht bazën e të dhënave të ndërtimeve pa leje, nëse për të është paraqitur aplikim për legalizim. Gjatë evidentimit në terren verifikohet edhe posedimi efektiv i ndërtimit nga subjekti përfitues. Ndërkohë të dhënat e kërkesës dhe të evidentimit në terren bëhen publike për 30 ditë, në ambientet e njësisë administrative ku gjendet pasuria, në ambientet e ALUIZNI-t, ZVRPP-së si dhe në faqet përkatëse ueb. Si rregull, nëse për ndërtimin është aplikuar për legalizim si ndërtim pa leje, ai përjashtohet nga fusha e zbatimit të këtij vendimi dhe trajtohet sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Përjashtim bën rasti kur nga korrespondenca e ALUIZNI-t me organet kompetente (të vetëqeverisjes vendore dhe Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit - AQTN) apo nga dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi arrihet të provohet se ndërtesa është ndërtuar përpara datës 10.8.1991.

**NDËRTIMET E PAREGJISTRUARA**

Për ndërtimet e paregjistruara ose të regjistruara pa titull pronësie, për të cilat nuk është paraqitur aplikim për legalizim, ALUIZNI verifikon nëse ndërtimi është i pranishëm në produktin e fotografimit ajror të Republikës së Shqipërisë të vitit 1994. Nëse ndërtimi ndodhet në territor të papërfshirë në këtë fotografim, ALUIZNI verifikon me radhë produktet e fotografimeve ajrore të viteve 1999, 2001 dhe në fund, atë të vitit 2007. Nëse ndërtimi është i pranishëm në të paktën njërin prej materialeve fotografike të mësipërme, ai prezumohet se është ndërtuar para datës 10.8.1991 dhe trajtohet sipas dispozitave të këtij vendimi. Krahas procedurave të mësipërme, brenda 20 ditëve nga konstatimi i gjendjes ndërtimore në terren, ALUIZNI u kërkon informacion për pasuritë truall dhe ndërtesë: a) ZVRPP-së, për të verifikuar nëse është të regjistruar më parë ose jo titull pronësie; b) ATP-së, për të verifikuar nëse është marrë ose jo vendim për kthimin e pronës. Institucionet e sipërpërmendura detyrohen të vendosin në dispozicion informacionin e kërkuar brenda 10 ditëve.

### KËRKESAT E POSAÇME

**1.** Me kërkesë të posaçme, subjektit mund t'i kalohen në pronësi pjesët e sipërfaqes shtetërore mbi masën e përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi, deri në 500 metra katrorë. Përjashtimisht, nëse nga konfigurimi i truallit funksional rezulton se krijohen sipërfaqe të lira, që tejkalojnë masën e 500 metrave katrore dhe që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtime të reja, subjekti mund të përfitojë kalimin e pronësisë edhe për to.

**2.** Në çdo rast, për pjesët e sipërfaqes që kalohen në pronësi sipas pikës 18, të këtij vendimi, subjekti paguan çmimin sipas hartës së vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Të ardhurat e arkëtuara sipas kësaj pike ndahen, si më poshtë vijon: a) 70 për qind në fondin e kompensimit të pronave, të parashikuar në ligjin nr.133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"; b) 30 për qind për llogari të ALUIZNI-t, për përballimin e shpenzimeve të evidentimit në terren dhe të shpenzimeve të tjera të procedurës administrative.

**3.** Në rastin e pretendimeve të ngritura nga të tretët gjatë procedurës administrative për të drejta mbi ndërtimin, ALUIZNI pezullon procedurën e kalimit të pronësisë dhe udhëzon palët t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Procedura vijon sipas përmbajtjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë.

**4.** Nëse gjatë njoftimit publik dhe verifikimeve sipas pikës 11 të këtij vendimi rezulton se vetëm për truallin funksional zotërohet nga të tretët titull pronësie (i regjistruar ose jo) apo se është marrë vendim për kthimin e pronës, ALUIZNI zbaton procedurat e kompensimit të pronarit joposedues me vendim të Këshillit të Ministrave. Regjistrimi i ndërtesës kryhet pa marrëdhënie me truallin, deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues.

**5.** Kur në objektin e ngritur përpara datës 10.8.1991 ose në truallin funksional gjenden zhvillime ndërtimore informale, ALUIZNI vepron në përputhje me pikën 1/2, të vendimit nr.280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", të ndryshuar, dhe pikën 18, të vendimit nr.465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale", të ndryshuar.

**6.** Objekti i regjistruar në regjistrin hipotekor deri në momentin e hyrjes në fuqi të dekretit nr.4823, datë 2.3.1971, "Mbi të drejtën e pronësisë", që nuk ka të cilësuar truallin, por vetëm kufijtë, do të trajtohet nga ZVRPP-ja si pasuri me sipërfaqe të papërcaktuar, sipas kërkesave të shkronjës "b", të nenit 25, të ligjit nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe të vendimit nr.745, datë 24.10.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen".

### PËRCAKTIMI I SIPËRFAQES

Në përcaktimin e sipërfaqes, ALUIZNI bazohet në kufijtë faktikë të sipërfaqes së poseduar, pa tejkaluar masën prej 300 metrash katrorë.

**1.**Për procedurën e ndjekur, subjekti përfitues paguan për llogari të ALUIZNI-t tarifën e shërbimit në vlerën 8 000 (tetë mijë) lekë për çdo kat ndërtimi, e cila përdoret për të përballuar shpenzimet e evidentimit në terren dhe shpenzimet e tjera të procedurës administrative. Kjo tarifë i njoftohet përfituesit menjëherë pas përfundimit të periudhës së afishimit, nëse përmbushen kushtet për të përfituar kalimin e pronësisë, sipas këtij vendimi.

**2.**Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet në favor të subjektit kërkues dhe bashkëshortit/es së tij, duke respektuar dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore martesore. Në rast se subjektet nuk paraqesin dokument që provon regjim pasuror martesor të veçantë apo marrëveshje të posaçme noteriale për të drejtat mbi ndërtesën, vendimi miratohet në favor të të dy bashkëshortëve, duke prezumuar regjimin e bashkësisë ligjore. Për zbatimin e kësaj pike, ALUIZNI administron certifikatën familjare të kërkuesit, sipas mënyrës së përcaktuar në vendimin nr.332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet brenda 20 ditëve nga administrimi i vërtetimit për pagesën e tarifës së shërbimit, por në çdo rast jo më herët se data e përfundimit të afatit të njoftimit publik.

**3.** ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin, së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.

Ziçishti: Presim rastet dhe i trajtojmë më pas në pavijone

# Urgjenca të mërkurave ofrohet në Sanatorium

## Urgjenca pediatrike, përgjatë gjithë kohës në QSUT




Të gjitha urgjencat kirurgjikale të mërkurave nuk do të ofrohen më në Qendrën Spitalore Universitare, por në spitalin "Shefqet Ndroqi", apo siç identifikohet ndryshe, Sanatoriumi. Vetëm urgjenca pediatrike do të ofrohet përgjatë gjithë kohës në QSUT. "Të gjithë vijnë këtu, edhe ata që shkojnë e paraqiten te 'Nënë Tereza', i dërgojnë këtu. Deri tani e kemi përballuar mirë dhe punët kanë shkuar mirë. Kjo është urgjenca që paraqiten në radhë të parë, pastaj ka ekzaminimet dhe pavijonet lartë", tha koordinatori i urgjencës, Ylli Ziçishti. Por, mjekët garantojnë se në asnjë prej urgjencave nuk do të vihet në rrezik jeta e qytetarit dhe shërbimi primar do t'i ofrohet në çdo urgjencë në çdo ditë të javës. Koordinatori Ziçishti shtoi: "Ka të sëmurë të palëvizshëm, të patransportueshëm që trajtohen atje. Ashtu si çdo ditë jave, në qoftë se i sëmuri vjen këtu që nuk lëviz, do t'i jepet ndihma këtu". Sistemi i ri i kalimit të urgjencave për një ditë në javë në një tjetër spital shërben për t'i dhënë mundësinë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" të shfryhet nga fluksi i pacientëve që bart gjatë javës.

**VENDIMI**

Çdo të mërkurë, pra katër herë në muaj urgjencat kirurgjikale do të përballohen nga Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", i cili tashmë është gati për pritjen e të gjitha urgjencave kirurgjikale. Për këtë janë marrë të gjitha masat për numrin e sallave të operacionit, praninë e të gjithë specialistëve si kirurg, anestezist, instrumentist dhe staf mbështetës. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ky lloj organizimi është i domosdoshëm jo vetëm për shpërndarjen e ngarkesës së punës në të gjitha spitalet universitare, por edhe për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për pacientët. Skënder Brataj, drejtori i Urgjencës Kombëtare, u bëri thirrje qytetarëve t'i drejtohen Urgjencës Kombëtare për çdo shërbim urgjence, duke telefonuar 127. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, nuk do të referohen në urgjencën kirurgjikale në Sanatorium rastet e sjella me helikopter, djegie-plastika, obstetrikë-gjinekologjia si dhe trauma.

**RAPORTI**

### Kostoja e dhunës në Shqipëri përllogaritet sa 3.8% e PBB-së



Në Shqipëri kosto e dhunës vlerësohet të jetë 315 dollarë për person ose sa 3.8% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Vlerësimi ka ardhur nga Instituti për Ekonominë dhe Paqen (IEP), i cili ka publikuar raportin, që jep një përshkrim të 162 shteteve në botë, ku Shqipëria renditet në vendin e 104. Në Europë ndodhen shtetet më të paqta në botë, ndërsa Afrika dhe Lindja e Mesme kanë performancën më të keqe. Pyetja që nxit ky raport është: Bota po bëhet më e paqtë apo po përkeqësohet? Raporti tregon se shtetet më të paqta në botë po bëhen gjithnjë e më të paqta, ndërsa atyre në gjendje lirie të munguar, po i shtohen trazirat më tepër. Raporti tregon edhe ndikimin ekonomik të pasojave të dhunës globale. Vitin e shkuar, kostot në të gjithë botën arritën 13.6 miliardë dollarë, por me ulje nga 14.3 miliardë dollarë që vlerësohej një vit më parë. Ndër 20 shtetet më të paqta në botë, 15 janë shtete evropiane. Raporti thekson se vendet me nivelet më të larta të paqes shpenzojnë midis 1 dhe 2% të PBB-së për sigurinë e brendshme. Vendet me nivele mesatare të paqes tentojnë të shpenzojnë më shumë, ndërsa ato vende me nivelet më të ulëta të paqes, në përgjithësi shpenzojnë më pak se një për qind të PBB-së për sigurinë e brendshme. Shtetet ballkanike janë pjesë e shteteve "fituese", që do të thotë, sipas raportit, janë edhe me shkallë përmirësimi të situatës së paqes, sikurse edhe me ulje të kostove të dhunës.


**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST**
**(CONSULTING SERVICES – INDIVIDUAL SELECTION)**
**Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting**
**Consulting Service**
**For**
**International Consultant**
**Support MOFE to lead the reform for IPSAS adoption and implementation (Preparation of an implementation plan of IAS)**

**ALBANIA**
**Project:** Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting
**Grant No.:** TF0A3277 (Portion A); TF0A5134 (Portion B)
**Assignment Title:** Support MOFE to lead the reform for IPSAS adoption and implementation (Preparation of an implementation plan of IAS)
**Reference No**. AL-CFCU-58021-CS-INDV

The Government of Republic of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting, and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The focus of the project is on two levels: i) the strengthening of the legal, regulatory and professional development of public sector accounting and financial reporting by developing a system based on international standards, and ii) the relative capacity building for implementation. The approach used will be that of gradual introduction of the IPSAS, in line with IT and treasury system developments, whilst developing the professional capabilities of the Ministry of Finance and Economy (MOFE) and public sector finance professionals.

The objective of the assignment is to provide technical assistance to the Government of the Albania in preparation of the Country Strategy and Action Plan and provide support during the implementation of the first phases of the reform.

The required consulting services ("the Services") include providing strategic advice and share good practices with project director and Project Steering Committee, Project Implementation Team and other stakeholders, in the field of IPSAS implementation and application of IPSAS Gap assessment findings, etc.

The assignment is a combination of deskwork from home and travel to the field. It will take place irregularly from July 2018 until June 2020. The consultant will be appointed for up to 82 working days. (At least 50 days are required to be spent onsite). The assignment envisages eight missions to travel to the field.

The detailed Terms of Reference (ToR) for the assignment can be found at the following website: ***cfcu.financa.gov.al***

The Central Finance and Contracting Unit invites individual consultants ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The consultant should have:

- to be professionally qualified expert and/or have an advanced degree in public sector accounting and financial reporting.
- at least 10 years of professional, practical experience in government accounting and financial reporting including an advanced level of knowledge of the application of IPSAS.
- a track record of publications in public sector accounting and financial reporting.
- fluency in English
- demonstrated capacity to function as a member of a multi-disciplinary team; to search for common ground where appropriate; and to focus on solutions and deliver quality results on time
- Proved experience in IPSAS transition plan, and implementation of respective change management and communication action plan.

Preferences will be given to consultant with:

- Active engagement in IPSASB activities.
- Academic titles and publications on IPSAS.

The attention of interested Consultants is drawn to Section III, paragraphs, 3.14, 3.16, and 3.17 of the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" July 2016 ("Procurement Regulations"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.
A Consultant will be selected in accordance with *the Open Competitive Selection of Individual Consultants (IC)* method set out in the Procurement Regulations, *Time Based Contract*.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays. .
**Expressions of interest (CV, Cover letter and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by fax, or by e-mail within July 31st 2018, local time 14:00.**

**Mrs. Enkelejda Kokthi, General Director**
**Central Finance and Contracting Unit (CFCU)**
**Ministry of Finance and Economy**
**enkelejda.kokthi@financa.gov.al**
**cfcu.financa.gov.al**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

**N J O F T I M**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të InstitucionittëKomisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

**Përkthyes (paga II-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:
a) Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

**Specialist Protokoll/Arkiv (IV-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:
a) Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor.
b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c) Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**
Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikate sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4,Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4,Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti).
- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Një rekomandim nga punëdhënësi.
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrojnë Komitetit ad-hocdokumentet e njësuara ose ato origjinale.

# Vrau me plumb në kokë 34-vjeçarin për borxhin 8 mijë euro, gjykata lë në burg Hysni Ramajn

**KRUJË**- Gjykata e Krujës dje ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Hysni Ramajt, i cili dyshohet të jetë një nga autorët e vrasjes me plumb në kokë 34-vjeçarin Kejsi Hysa. Trupi i pajetë i të riut nga fshati Gjorm i Kurbinit, i cili ishte denoncuar i zhdukur që me 5 korrik të këtij viti u gjet i groposur të premten që shkoi në fshatin Shelqet të Komunës Nikël në Fushë-Krujë. Pas paraqitjes së provave materiale, togat e zeza të Krujës kanë lënë në qeli pronarin e mobilierisë, i cili ditën e zhdukjes së 34-vjeçarit kishte lënë takim me të. Gjithashtu, gjykata ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" edhe për shtetasin Agron Tufa, i cili është shpallur në kërkim, si autor i dytë i vrasjes. Gjatë fjalës së tij në sallën e gjyqit, 31-vjeçari Hysni Ramaj, ka treguar dinamikën e vrasjes. Ai ka pranuar autorësinë e krimit, ndërsa është shprehur se vrasja ka marrë shkas nga shuma prej 8 mijë eurosh që dy autorët i kishin borxh viktimës. "E vramë Kejsi Hysën, pasi i kishim 8 mijë euro borxh. Ai na kërkoi lekët, na shau dhe ofendoi", ka thënë Ramaj. Viktima ishte në kërkim nga policia, pasi 3 vite më parë në bashkëpunim me persona të tjerë dyshohet se ka vrarë Edmond Theodhorin në Sarandë.


Viktima Kejsi Hysa

Autori pas arrestimit: U zumë për një kapele, e qëllova Hermes Beqirin pasi më rrahu

# Ekzekutoi shokun me kallash për një kapele, 17-vjeçari mohon krimin

## Elvis Hoxha në gjykatë: S'jam unë autori i ngjarjes, isha te dajat në Malësi të Madhe

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Gjyqi ndaj të akuzuarit për vrasjen e 23-vjeçarit Hermes Beqiri në Shkodër ka marrë një rrjedhë tjetër. Autori i dyshuar, Elvis Hoxha ka ndryshuar dëshminë e tij para trupit gjykues. Ai ka deklaruar në seancën e djeshme gjyqësore se nuk është ai autori i vrasjes dhe se nuk ka qenë aty në momentin kur ka ndodhur krimi. Ndërkohë që më herët ai kishte pranuar se e vrau me breshëri kallashnikovi Beqirin, pas një sherri për një kapele në një lokal në zonën e njohur si ish-Zooteknika, në lagjen "Guerile". Pas dëshmisë së dhënë nga 17-vjeçari, seanca gjyqësore u shty me 25 korrik, pasi togat e zeza të qytetit verior pritet të njihen me disa prova të reja. Mësohet se prokuroria ka kërkuar qelizat telefonike të autorit të dyshuar, për të saktësuar vendndodhjen e tij në momentin e krimit. Kjo për faktin se Elvis Hoxha pretendon se në momentin e vrasjes së ndodhur në nëntor të vitit që shkoi ka qenë te dajat në Malësinë e Madhe dhe jo tek lokali ku ndodhi ngjarja. Po ashtu pritet të thirren dëshmitarët okularë të ngjarjes për të dëshmuar. Në total janë 8 dëshmitarë. Prokuroria ende nuk ka dalë me pretencën, por në provat e paraqitura është arma e krimit që është gjetur në momentin e arrestimit të Hoxhës, xhaketa e autorit të dyshuar që prokuroria pretendon se ka mbetje baruti në të dhe deklaratat e disa prej dëshmitarëve pak ditë pas vrasjes së ndodhur. Fillimisht Elvis Hoxha (në paraburgim), por edhe para nisjes së gjyqit të themelit ka pranuar autorësinë, por më pas e ka ndryshuar versionin e tij duke pretenduar se ka qenë në Malësi të Madhe te dajat, kur ka ndodhur vrasja dhe se nuk ka lidhje me atë krim. Tashmë pritet zhvillimi i seancës së radhës me 25 korrik dhe seancave të tjera për të parë vendimin përfundimtar të kësaj çështje.


23-vjeçari i vrarë Hermes Beqiri

**NGJARJA**

23-vjeçari Hermis Beqiri u qëllua mbrëmjen e 5 nëntorit 2017 teksa ndodhej në një lokal në lagjen "Guerile" të qytetit të Shkodrës bashkë me disa shokë të tjerë. Sherri erdhi pas një loje për një kapele që viktima mendohet se ia ka vënë në kokë autorit të dyshuar. Pak çaste përpara plagosjes, mësohet se Hermes Beqiri e ka rrahur 17-vjeçarin . Ky i fundit ka shkuar dhe ka marrë një kallashnikov. Është afruar tek dera e lokalit dhe nga aty e ka qëlluar. Për pasojë, Beqiri mbeti i plagosur rëndë, por pas orësh ndërroi jetë në spitalin e Traumës në Tiranë. Policia arrestoi 17-vjeçarin mbrëmjen e ngjarjes. në një ndërtesë në fshatin Grudë. Ai u kap teksa mbante në dorë automatikun dhe fare pranë kishte edhe motorin, me të cilin ishte larguar nga vendngjarja, që u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Gjithashtu u vunë në pranga edhe dy shokët e autorit, Ditmir Harifi, dhe Bekim Turishta, të cilët akuzohen për "Moskallëzim krimi". Gjatë marrjes në pyetje, 17-vjeçari i arrestuar pohoi para bluve: "Ne jemi ngatërruar për një kapele. Nisi pak si lojë, por më pas situata u bë serioze. Aty ngritëm zërin dhe ai më rrahu. Më pas kam marrë automatikun dhe e kam qëlluar. Nuk kam dashur ta vras".



## I gjenden në lokal 7 kallëpe dinamit, prangoset pronari

**DIBËR** - Policia e Dibrës ka sekuestruar një sasi me lëndë plasëse, ndërsa ka vënë në pranga një 52-vjeçar. Bëhet fjalë për Njazi Pilafi, banues në Peshkopi. Sipas burimeve nga policia lokale, arrestimi i tij u bë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në magazinën e lokalit të tij në qytetin e Peshkopisë, iu gjetën të fshehura dhe iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 7 kallëpe me lëndë plasëse (me nga 400 gr secila, gjithsej 2 kg e 800 gr),58 kapsolla detonatore si dhe rreth 4 metër fitil zjarrpërçjellës. Materialet hetimore në ngarkim të 52-vjeçarit do t'i referohen Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për veprën penale: "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".


ISLAMIC RELIEF
WORLDWIDE
Rr. "Durrësit" Laprakë E Re Blloku Gintash, Pall. E, Ap 8, Tirana, Albania
Tel: (+355) 424 13 190
E-mail: info@islamicrelief.al

**Ftesë për Tender**

Fondacioni Islamic Relief- Albania Office ka hapur ftesën për ofertë me objekt:

**"Blerje Mishi per Projektin e Kurban Bajramit 2018"**

**Informacion I pergjithëshem**:
1. Te gjitha bagetit duhet te jetë te pështatshem per te permbushur kriteret e kurbanit.
2. I gjithe mishi duhet te jete 100 % hallall.

**Kerkohet nga kompania e interesuar per kete bashkepunim qe te perfeshije sherbimet:**
1. Sigurimi Produktit te Mishit,
2. Te siguroj thertore, me te gjitha standartet higjeno-sanitre dhe kapacitet e nevojshme,
3. Te siguroj transportin me makina frigoriferike,
4. Te kryej paketimin e pakove te mishit (1 pako permban 4 kg mish),
5. Te ofroj fature tatimore.

**Oferta kerkohet për:**
**Dele – 245 cope (Type:** Dele (mashkull), **Pesha:** Minimumi 45 Kg dhe Max 55 Kg (pesha e gjalle) mesatarja 27 KG mish neto pasi eshte therur (Duke hequr kokën, këmbët dhe te brendshmet e kafshës). **Mosha: 1 - 2 ½ Vjec )**
**Viça – 35 cope Type:** Viç, **Pesha:** Minimum 180 Kg (peshe e gjalle) mesatarja 99 KG mish neto pasi eshte therur (Duke hequr kokën, këmbët dhe te brendeshmet e bagetise), **Mosha: 2 - 4 ½ Vjec**
Oferta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vulosur dhe duhet dërguar në adresën:
Adresa: Laprake, rruga e Durrësit, Blloku Gintash, pall E, kati i II, ap 8, Tirana ose mund ta dergoni ne posten elektronike: info@islamicrelief.al

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën **07.08.2018.**
Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info@islamicrelief.al ose te kontaktoni ne:
Tel. : +355 42413190, Cel. : +355 67 34 53330


## Gjon Ndue Marku licencoi një kompani udhëtarësh

# Abuzoi me detyrën, merret i pandehur ish-kryetari i Bashkisë së Vaut të Dejës

**SHKODËR**- Prokuroria e Shkodrës ka dërguar për shqyrtim dosjen në gjykatë për ish-kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, Gjon Ndue Marku, pasi akuzohet për 'Shpërdorim detyre'. Sipas hetimeve paraprake të rezulton se Gjon Ndue Marku gjatë kohës që ka qenë kryetar bashkie gjatë viteve 2011-2015, ka lëshuar një licencë si dhe një certifikatë për transport udhëtarësh në kundërshtim me detyrën. "Në Shkodër, sot me datën 18.07.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë si të pandehur për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", ish-kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, shtetasin Gjon Ndue Marku, dhe ka dërguar çështjen penale për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga hetimet e kryera rezulton se shtetasi Gjon Ndue Marku, me detyrën e kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës gjatë periudhës 2011-2015, ka lëshuar një licencë si dhe një certifikatë "Për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve", në kundërshtim me detyrën. Licenca është lëshuar në kundërshtim të hapur me nenin 11 pika 5.1 germa "f" dhe 5.2 të udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar", thuhet në njoftimin zyrtar të prokurorisë.



Probleme me pasurinë edhe gjyqtari Metalla, s'justifikon blerjen e një apartamenti

# Procesi i vetingut, KPK: Prokurori i Tiranës ka fshehur pasurinë

## Arben Nela: Nuk i keni llogaritur siç duhet

**TIRANË**

Arben Nela, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është përballur dje me Komisionin e Pavarur të Kualifikimi. Trupa gjykuese përbëhet nga Etleda Çiftja, Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari. Nela është kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, çfarë e bën pjesë të listës prioritare. Në seancë, KPK ka lexuar raportin për prokurorin në fjalë. Sipas ILDKPI, Arben Nela nuk ka bërë deklarim të saktë dhe po kështu, s'ka burime të mjaftueshme financiare. Raporti thotë se prokurori Nela ka bërë fshehje të pasurisë. Sipas raportit, ai ka një apartament 99.4 m2, blerë në vitin 2011 për 41 mijë euro, në bashkëpronësi me gruan. Sipas deklarimit, apartamentin e ka blerë me kursimet në vite nga puna që prej 1998 dhe kursimet e gruas, e cila punon në Ministri të Transporteve dhe profesoreshë. Për blerjen e kësaj shtëpie, prokurori ka deklaruar se ka marrë borxh prej 25 mijë eurosh edhe nga motra e gruas. Sipas KPK, për këtë apartament ka mospërputhje në deklarimet e pasurisë ndër vite. Ndërsa për borxhin e marrë nga kunata është e paqartë se kur ia ka marrë dhe kur ia ka kthyer. Po kështu, ai zotëron një banesë 121.6 m2 në Lanabregas, në proces legalizimi. Prokurori thotë se tokën e kanë blerë prindërit e tij dhe kanë ndërtuar shtëpinë nga vitit 1999. Por, KPK thotë se ka paqartësi dokumentesh. Prokurori Nela nuk ka deklaruar në deklaratë aplikimet që ai ka bërë në vite për ta legalizuar këtë shtëpi. Ndërkohë, gruaja ka edhe një apartament ku është 100% zotëruese. Apartamenti është me vlerë 52 mijë euro dhe me sipërfaqe 67.6 m2. Gruaja thotë që e ka blerë me të ardhura sipas një kontrate huaje me të motrën. KPK thotë se ka paqartësi dokumentesh. Ndërkaq, vetë prokurori Arben Nela ka mohuar se ka fshehur pasurinë para trupës gjykuese të KPK. "Nuk kam fshehur pasuri, nuk i keni llogaritur siç duhet. Nuk ekziston asnjë fakt që unë kam fshehur pasuri, raporti sjell fakte të shtrembëruara qëllimisht. ILDKPI ka interpretuar qëllimisht pasuritë e mia me keqdashje", deklaroi Nela.



Gjyqtari Ervin Metalla



Prokurori Arben Nela

**GJYQTARI METALLA**

Një tjetër gjyqtar i Apelit Tiranë do të kalojë në "sitën" e vetingut. Bëhet fjalë për Ervin Metallën. Mësohet e Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka lexuar raportin e pasurisë për Metallën. Trupa gjykuese e kryesuar nga Etleda Çiftja, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari ka marrë në shqyrtim verifikimin për gjykatësin. Bazuar tek raporti i ILDKPI, KPK theksoi se gjyqtari Metalla nuk ka bërë fshehje pasurie, ndërsa bëhet e ditur se ai ka pasur burime të mjaftueshme financiare. KPK mes të tjerash deklaron se ka bërë hetim të thelluar për Metallën, i cili rezulton se ka blerë me kredi një apartament me sipërfaqeje 96 m² dhe garazh 22.5 m². Po ashtu, KPK bën me dije se gjykatësi pasi ka pasur probleme me kredinë e marrë, e ka kaluar atë në emër të të vëllait të tij, për të përfituar një kredi të butë. Më pas gjyqtari tha se shumën e marrë nga kredia e përdori për të blerë apartament. Ndërkohë, KPK ka konstatuar se Metalla gjatë kohës që ka qenë gjyqtar ka përfaqësuar në Strasburg një kompani, në kundërshtim me ligjin.

**SHKARKOHET GJYQTARI I LARTË, ARTAN ZENELI**

Artan Zeneli, anëtari i Gjykatës së Lartë nuk ka mundur të kalojë procesin e vetingut. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga Etleda Çiftja, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari, pas seancës dëgjimore ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Aktualisht Gjykata e Lartë është në prag kolapsi, pasi ka mbetur me 6 gjyqtarë nga 19 që duhet të ketë në total. Artan Zeneli kandidoi më herët për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.




bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by giz

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

**Press Notice**

**To the attention of the general public**

**Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS**

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018.**

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EUROs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitinalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitinalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

**The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.**



bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by giz

**ANNOUNCEMENT**

**Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals**

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

**Selection Procedure:**

**First step**: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

**Second Step**: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

**Third Step**: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.

### Gjashtë dokumentet dhe formulari TIP që duhet të dorëzoni në 'Agjenci'

# ATP çel aplikimet për fondin 74 milionë lekë, përfitojnë 370 pronarë

## *Dosjet pranohen në 23 korrik, përfituesit në të gjithë vendin*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave çel në 23 korrik procedurat e pranimit të dokumenteve për pronarët që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, është 74 212 100 lekë dhe janë në total rreth 370 pronarë që përfitojnë nga fondi. "Agjencia e Trajtimit të Pronave njofton fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.433, datë 11.07.2018. Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 23.07.2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjitha subjektet e interesuara të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga 'Muhamet Gjollesha', nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatës", - thuhet në njoftimin e ATP-së.

**DOKUMENTET**

Subjekti kërkues (subjekti përfitues/trashëgimtari ligjor/përfaqësuesi me prokurë), në momentin e plotësimit të kërkesës për kompensim, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: kërkesën për kompensimin e pronës, dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, prokurën e posaçme të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare, fotokopjen e dokumentit të identifikimit, mandatpagesën. Subjektet përfituese, kërkesa e të cilave nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.

### DOKUMENTET

**1.**Kërkesa për kompensimin e pronës, sipas formatit TIP, që i vihet në dispozicion nga ATP-ja.
**2.**Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.
**3.**Prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre.
**4.**Vërtetimi origjinal i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfituar.
**5.**Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
**6.**Mandat pagesa që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 lekë.

## LISTA ME PERFITUESIT

**TIRANE**
BAJRAM SELIM CANI
SHEMSI MUSTAFA HOXHA
LULJETA TON KOVACI
FERID REXHEP BERBERI
ELONA ILIR ZACAJ
NDRICIM LUTFI LLOCI
ISMAIL HASAN BUCPAPAJ
HEKURAN LUTFI LLOCI
EDISON BAFTJAR VISHA
MANUSHAQE BAJRAM KODRA
PASHK DED BRUKA
KASTRIOT ISLAM CUKA
LUAN ISLAM CUKA
FATOS ISLAM CUKA
THOMA FORE ZYBA
RAJMONDA MALIQ ZYBA
BARDHOK PJETER GJONPJETRI
EMNOR NIJAS KALA
ALBERT RAMIZ DUDA
PERPARIM SABRI SALLAKU
BESNIK ISUF KOTARJA
RUZHDI LIK XHAFA
ASTRIT BAKI GAGUSHI
XHEMAL QAZIM KODRA
SIMON GJIN DODAJ
BLERIM IMER MASHA
FLATUN KORB BENACA
GURALI TELHA DAUTLLARI
QEMAL SHAQIR KOCI
ERALDO QEMAL KOCI
ASTRIT OSMAN BALLA
EDUART TAHIR NURI
HAXHI MUHARREM SALLAKU
VESEL RAMAZAN HOXHA
ARBEN RAMAZAN SALLAKU
ELIS QEMAL KODRA
PRENG QERIM DOCI
SHKELQIM DEMIR FUSHA
SHABAN ARIF HAXHIJAJ
HASIM XHAFERR CENI
LULEZIM GANI KODRA
ERVIS ENVER KORTESHI
ARBEN BANUSH PICI
RUZHDI IP DACI
NDUE GJON NIKOLLI
ARBEN NAZIF MILA
FATMIR SHEFQET RUCI
ANTON GJON PICAKU
ADAM ANTON PICAKU
ISMAIL AHMET VAKA
NUREDIN JAHJA KANAPARI
RINOR MENTOR BEQIRI
MENTOR BEZAT BEQIRI
PETRIT ALI HIDRI
SHKELQIM ISUF BULKU
RAKIP HAJRULLA KORRIKU
ALTIN SHKURT ALLBANI
NDOC NDUE MARKU
AGIM NEZIR ALLDERVISHI
CLIRIM FERHAT MUCA
JORGO KOCO DEDE
GANI ABDULLA BRAHJA
ILIR BAJRAM TABAKU
REXHEP KASEM RROSHI
XHEVAHIR HIDAJET SHEHU
FREDI HIDAJET SHEHAJ
XHEVAHIR RRAPUSH BRAIMLLARI
SHKELQIM FEZULLA HETA
ASTRIT FEZULLA HETA
LUFTAR ZYBER VESELI
HALIL ALI KOLOSHI
BUJAR YMER VISHA
LATIF HYSEN VISHA
ZIJA KAPLLAN CEKA
MYZEJEN SULEJMAN BILBILI
FATMIRE RAMDAN COLLAKU
ALI RAMAZAN DEMA
ALMA RAMAZAN PINARI
ALBI PELLUMB PINARI
EDUART RAMAZAN DEMA
ENGJELLUSHE ENVER GOSTIVARI
GAZMEND ALI GOSTIVARI
SHKELQIM ALI GOSTIVARI
LEDINA ELMAS KABASHI
XHEVDET ELMAS CELO
ALMA ALI SPAHIU
AIDA ALEKSANDER BUSHATI
ILIRJAN KOL BUSHATI
ERVIN ALFRED BUSHATI
VIOLLCA MYFTAR BUSHATI
GJERGJ ALFRED BUSHATI
VENERANDA KOL BUSHATI
ALBENS ALEKSANDER BUSHATI
NAIM RAMAZAN LEKA
VILMA BARDHYL LEKA
ALEKSANDER NACI
AMALIA HIDO
KLODIANA PANDO
IRENA VANGJEL
STEFANIA LUBONJA
**BERAT**
ALKETA REFAT ÇOBO
YLLI HAMET SELAMAJ
YLLI HAMET SELAMAJ
HAMET DASHMIR SELAMAJ
SAFET BEKTASH TOMORI
NURI RAMADAN ÇOBO
FLORJANO ROLANDO STEFANI
MARJANTHI ZOI STEFANI
GENCI AMET BERBERI
KASTRIOT FAIK TAIPI
FERDINAND SHABAN KURTI
RENATO XHEMAL QEVANI
XHEMAL SAMI QEVANI
XHEMAL SAMI QEVANI
MIRJAN FEJZI KOXHAJ
HAXHI TOFIK FISKA
SOKOL FASLLI MEMA
AGIM KASËM MERKAJ
ENTILJANO GRANIT SPAHIU
XHEVAIR IZET TABAKU
LAVDOSH ILMI ADËRI
NOVRUS AVDULLA KËRKUTA
ILIR NEHAT KALLUÇI
ALGEN GËZIM BAZAJ
PETRIT ADEM BAHO
KUJTIM NAZIF ZYLALI
GËZIM HALIM QAMO
KRENAR MUÇO KAPEDANI
EDUART AVDURAMAN KOLONJA
SOKRAT THIMI DHANA
HAJREDIN ELMAS LYBESHARI
KOSTA HAMZA RUÇI
SEFEDIN MYRTEZA DOKO
ZAMIR FETI TAFA
**DIBËR**
PAJTIM MEDI MEDIU
Asllan Bardulla
Arben Shuaip Shehu
Basri Nerulla Shehu
Drita Rexhep Shehu
Tomor Shuaip Shehu
Xhelal Shuaip Shehu
**ELBASAN**
TAJAR BEHXHET HOXHA
YMER SHYQYRI SHKEMBI
FLORENT SKËNDER TAFA
SONILA JEMIN TAFA
GEZIM KADRI QEVANI
SELMAN BIDO DEDJA
ZEDEF YZEIR HOXHA
FASLLI SABRI RAGA
NIKO FASLLI RAGA
ALFRED FASLLI RAGA
QAMIL YZEIR METUSHI
RUSHIT YZEIR METUSHI
GAZMIR RIZA XIBRRAKU
LUAN ISUF MYZEQARI
ELTON FATMIR XHELILI
AVNI IDRIS BAKU
APOSTOL MITËR SHQAU
XHULEJTA VENEMIN SHQAU
RRAPUSH LIMAN BUZANI
LLAZAR VANGJEL BEZHANI
XHEVDET JANUZ SHABANI
XHAFERR HALIL PISHA
EMILJAN NAZMI ZEJNELI
EDMOND ZEQIR ÇARKU
LEONARD ZEQIR ÇARKU
PETRO MIHAL SINANI
HYQMET LIMON BRAGJEÇI
ILIR ISMAIL KLLOGJRI
PERPARIM JOSIF ÇAKALLI
AGRON VEIZ MUÇA
KAPLLAN XHEMAL LLESHI
NAZMI GANI HOXHA
SKENDER KASEM ÇARKU
ANDREA YZEDIN SHAHINI
SHKËLQIM ISLAM ELEZI
MERITA NEZIR ELEZI
BEXHET TEFIK KAPLLANI
BUKURIJE RAHMAN KAPLLANI
OSMAN YMER JAZO
ERMIRA FADIL JAZO
SHAZIVAR MASAR KARAOSMANI
SHEGUSH MASAR KOSOVA
FATBARDH SAMI DOKO
ARBEN SAMI DOKO
NESFIJE TEKI SELENICA (TELA)
BULENT TEKI TELA
EDMOND TEKI TELA
AGRON TEKI TELA
GJERAK MAZLLEM KARAISKAJ
FELATUN MAZLLEM KARAISKAJ
NEBI ISMAIL SEFA
HAJALI ISMAIL YPI
XHANETA ISMAIL PRODANI
SUHELA XHEVDET LIBOHOVA
TEUTA SKENDER FOR A
LAVDIJE SKENDER KALASA
ADEM BAKALLI
AISHE BAKALLI
DELIMET MEHMET BANGA
HEDIJE LEKA
XHULJETA LEKA (TREPSENISHTI
ARBANA LEKA (GRECA)
CENO METUSHI
EDIS CENO METUSHI
SABRIJE VOGLI
KAROLDA ALI VOGLI
MIRELA ALI DOCI
MERITA BESIM IPEKU
ARDJAN MEHMET IPEKU
LUELDA RAMIZ IPEKU
MEHMET IPEKU
FATMIRA XHAFERR IPEKU
ILIRJAN REXHEP LEKA
ALI MUSTAFA SUBASHI
ISMAIL MUSTAFA SUBASHI
ALEMSHA SUBASHI
MANUSHAQE SUBASHI
NEXHMIJE SUBASHI
SUZANA SUBASHI
NAZMI SUBASHI
FATUSHE SUBASHI
DURIM SUBASHI
SHPRESA SUBASHI
ERMIRA SUBASHI
BESA SUBASHI
MAHMUT HASTOPALLI
FATIME HASTOPALLI
SHKENDI RUSI
LUAN BAHOLLI
TEFTA BAHOLLI
NAZIF BAHOLLI
SKENDER BAHOLLI
LAVDIJE SERJANI
GAZMEND HASEKIU
IBRAHIM HASEKIU
ARDJAN HASEKIU
FAIK SINANI
MEHMET GRACENI
VJOLLCA PAPADHIMITRI
ILIR GRACENI
ULIS HASTOPALLI
JETA BASHA
ENGJELL DAKU
ARJANA PAPAMIHALI
RIZA ÇIFTJA
ZYRA MALUCA
MAKENSEN BUNGO
ATILIJE BODINAKU
SHYQYRI HYSKJA
LORETA HYSKJA
HYSEN HYSKJA
FERIJE BYLYK-BASHI
ADRIANO HASTOPALLI
ORNELA HASTOPALLI
Servete Fiqiri Dyrmishllari
Fedane Fiqiri Qorri
Mirjete Fiqiri Qorri
Diana Fiqiri Qorri
Asllan Fiqiri Qorri
Perparim Fiqiri Qorri
Bukurie Fiqiri Qorri
Mesare Fiqiri Qorri
Servete Fiqiri Dyrmishllari
Fedane Fiqiri Qorri
Mirjeta Fiqiri Qorri
Diana Fiqiri Qorri
Asllan Fiqiri Qorri
Perparim Fiqiri Qorri
Bukurie Fiqiri Qorri
Mesare Fiqiri Qorri
**KORÇË**
HEKURI SHEFKI PEPI
HEKURI SHEFKI PEPI
MARIGLEN HEKURI PEPI
Maksi Miti Qirici
**LUSHNJË**
ARJAN FEJZI LIKJA
VESEL MUSTAFA LIKJA
NABILE MUSTAFA LIKJA
SABIJE MUSTAFA LIKJA
BALLKËZE HAZIS LIKJA
MUSA HAZIS LIKJA
NIGJARE HAZIS LIKJA
HANE LIKJA
BEHAR HAZIS LIKJA
AZIS FEJZI LIKJA
ROLAND FEJZI LIKJA
**SHKODËR**
GJELOSH LULASH LAMTHI
RUZHDI RIFAT VRANJA
MAHIR ISMAIL HOTI
ISMET FADIL HOXHA
GLITON FADIL DIBRA
SHKELQIM ISMET XHAFERI
GLEDIS BASHKIM HALLUNEJ
OREJETA QEMAL HALLUNEJ
MARSIDA BASHKIM HALLUNEJ
AKIB ASIM BEHRI
SHAQIR RUZHDI ARKIVANI
YLLI GAFURR MUÇA
DORIAN SHYQYRI NEZIRI
VEHBI HASAN TRUNGAJ
ARTUR MARK GJONAJ
KRENAR BESHO MATUKA
FIQIRI XHELAL XHAFERI
AFERDITA MYFIT XHAFERI
ASTRIT FERIK LIKAJ
ERVIS FERIK META
**LEZHE**
GJON MHILL LLESHI
MRIKE NIKOLL PRENGA
ZEF EJELL GAZULLI
GAC PASHUK GAZULLI
GLEN TOM DEDA
LLESH PREÇ COLI
DODE PREÇ COLI
ZEF NDUE KALAJ
VALENTIN GEG SMAÇI
FRAN GJERGJ GERA
ALTIN ZEF NDOKA
MARTIN PJETER KOLA
ARMANDO PJETER NOKA
LEK NIKOLL PRENGA
DRITAN GJON CEKA
ELVIN GEZIM CARA
FRAN MARK KOLA
BARDHYL FRROK PACI
PASHKO RROK DEDA
DENIS VASIL PJETRUSHAJ
TOM SIMON PJETRUSHAJ
NIK DED PERAJ
NIKOLL GJON FILIPI
PJETER MARK MARKU
LADOVIK PREK VATAJ
EDUART RROK PEMAJ
NDUE NDREC MARKU
LEON ZEF NDOCI
ALFRED LEK NDOKA
TEODOR MARK PERLLESHI
ALBERT DOD KQIRA
ZEF NDREC FILIPI
DILE FRROK FILIPI
PETRIT ZEF FILIPI
KOL PASHK GEGA
PETRIT PRENG PERGJIVUKA
GEZIM PRENG PERGJIVUKA
DED SIMON CELAJ
TONIN DED CELAJ
MARGERITA DEDE LULGJURAJ
ILIR KOLE MARKU
PRENG GJIN PREKA
BARDH GJON GJERGJI
PRENUSHE PRENG BROZI
EDISON NIKOLL DEDA
NIKOLL DED DEDA

### Thaçi: Serbia na konsideron ende pjesë të saj, takimi me Vuçiç shumë i vështirë

# Lajmi i mirë për Kosovën, Avramopoulos: Plotësohen kriteret për liberalizim vizash

## *Takimi me Mogherinin, Kocijançiç jep detaje*

Komisioneri evropian për Migracionin, Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë, Dimitris Avramopoulos, në një shkrim autorial dërguar "Kohës Ditore", ka thënë se Kosova ka arritur progres dhe kriteret për liberalizim vizash janë plotësuar. "Ky është një kapitull i rëndësishëm në historinë tonë të përbashkët, Kosova i plotëson kriteret për liberalizim të vizave", ka thënë Avramopoulos, raporton "Koha.net". "Pas shumë vitesh e muajsh të përpjekjeve dhe punës së madhe, komisioni tashmë konfirmon se Kosova i ka përmbushur të gjitha standardet për liberalizimin e vizave. Tashmë, ne inkurajojmë Këshillin dhe Parlamentin Evropian që të lëvizin përpara me propozimin tonë. Unë vërtetë shpresoj se jemi shumë pranë një regjimi pa viza për të gjithë rajonin, i cili do të vendoset shumë shpejt", ka theksuar Dimitris Avramopoulos, Komisioneri evropian për Migracionin, Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë. Gjithashtu dje, komisioneri Avramopoulos, bashkë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi mbajtën konferencën për media ku u dha lajmi për plotësim të kritereve për liberalizim të vizave. Kadri Veseli, kryeparlamentar i Kosovës, pas takimit të djeshëm me Mogherinin, tha se rekomandimi për liberalizim vizash është hapi i parë drejt hyrjes në fuqi të vendimit. Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj tha se Parlamenti Evropian më 29 apo më 30 gusht do të mblidhet për të miratuar vendimin e KE-së e më pas të shkojë edhe tek Këshilli i Ministrave të BE-së që të kalojë edhe në nivel të ministrave të Rendit, ku tha se do të jetë pak më vështirë, "por jemi me shpresë të madhe që sot po përmbyllim një temë shumë të rëndësishëm për qytetarët e vendit, lëvizjen e lirë". Nga ana tjetër, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas raportit pozitiv të BE-së që i hap rrugë liberalizimit të vizave, ka thënë se është shumë i lumtur në këtë ditë, të cilën ai e ka vlerësuar si shumë të rëndësishme për Kosovën. "Vendimi i sotëm i Komisionit Evropian është ndër lajmet më të mira që kanë pritur qytetarët e Kosovës me dekada. Kjo përbën një moment historik dhe vlerësim për angazhimet shumëvjeçare për integrimin e Kosovës në institucionet evropiane", deklaroi Thaçi. "Kilometrat e fundit vërtetë kanë qenë të gjata dhe shumë të rënda për ne, por jam i lumtur që kemi arritur në një cak shumë të rëndësishëm. Liberalizimi i vizave është momenti më i veçantë në rrugën evropiane të Kosovës. Sot ka filluar shembja e murit të izolimit të një shoqërie", ka thënë presidenti Thaçi gjatë një konference të përbashkët me Komisionarin e BE-për për Migrim, Çështje të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, i cili ka thënë se Kosova tanimë i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave. Ndërsa zëdhënësja e Komisionit Europian për Politika Fqinjësore dhe Negociata të Zgjerimit, Maja Kocijançiç ka dhënë detaje nga takimi që u zhvillua në Bruksel mes Frederica Mogherinit dhe delegacionit kosovar. Mogherini në postimin e saj përsëriti arsyet e këtij takimi të liderëve kosovarë me Mogherinin, ndër to edhe çështja e liberalizimit të vizave. Kocijançiç ka postuar foto nga takimi në fjalë në llogarinë e saj në "Twitter". "Federica Mogherini takon Hashim Thaçin, Ramush Haradinajn, Kadri Veselin dhe Behgjet Pacollin, si dhe delegacionin kosovar të dialogut, por po ashtu që të diskutojnë perspektivën për liberalizim të vizave dhe progresin në rrugën drejt BE-së". Kujtojmë se dje delegacioni kosovar u takua me Eurokomisarin për Migrim, Dimitris Avramopulos, ku u dha edhe lajmin për vizat. Nga ana tjetër, presidenti Hashim Thaçi ka folur para mediave edhe pas takimit që pati me presidentin serb, Aleksandër Vuçiç, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini. Thaçi ka përsëritur disa herë se ky ishte takimi i tij më i vështirë në 6 vjet negociatash me Serbinë, edhe pse zgjati vetëm pak minuta. "Ka qenë më i shkurti dhe më i vështiri prej takimeve që kemi realizuar gjashtë vitet e fundit", ka thënë Presidenti Thaçi. Ai ka treguar se në takim Vuçiç shprehu qëndrimin se Kosova akoma shihet si pjesë e Serbisë. "Serbia ende beson se Kosova është pjesë e tyre. Kanë mentalitet të gabuar. Mashtrohen, gabohen shumë", u shpreh presidenti. Marrëveshja finale, sipas Thaçit, duhet të arrihet dhe ajo duhet të jetë e dobishme për të dyja vendet. "Ne ende shpresojmë që do të arrijmë një marrëveshje finale, që do të jetë e mirë për Kosovën për Serbinë dhe për investimin e BE-së", ka thënë ai. "Një marrëveshje që lehtëson të ardhmen e të dyja vendeve dhe popujve tanë, sjell mirëkuptim dhe pajtim. Pres vështirësi edhe më të mëdha, pres pengesa". Thaçi përsëriti disa herë se takimi me Vuçiçin ishte shumë i vështirë, por të tillë e pret edhe në vijim. "Javët dhe muajve të ardhshëm pres që të jenë edhe më vështirë, por do të vazhdojnë negociatat". Në fund, Thaçi tha se Kosova pret njohje formale nga Serbia në fund të dialogut dhe anëtarësim në të gjitha organizatat ndërkombëtare.



Komisioneri evropian për Migracionin, Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë, Dimitris Avramopoulos



**HASHIM THAÇI**

"Vendimi i sotëm i Komisionit Evropian është ndër lajmet më të mira që kanë pritur qytetarët e Kosovës me dekada. Ky përbën një moment historik dhe vlerësim për angazhimet shumëvjeçare për integrimin e Kosovës në institucionet evropiane. 'Kilometrat' e fundit vërtetë kanë qenë të gjatë dhe shumë të rëndë për ne, por jam i lumtur që kemi arritur në një cak shumë të rëndësishëm. Liberalizimi i vizave është momenti më i veçantë në rrugën evropiane të Kosovës. Sot ka filluar shembja e murit të izolimit të një shoqërie", ka thënë presidenti Thaçi.



**DIMITRIS AVRAMOPOULOS**

"Ky është një kapitull i rëndësishëm në historinë tonë të përbashkët, Kosova i plotëson kriteret për liberalizim të vizave. Pas shumë vitesh e muajsh të përpjekjeve dhe punës së madhe, komisioni tashmë konfirmon se Kosova i ka përmbushur të gjitha standardet për liberalizimin e vizave. Tashmë ne inkurajojmë këshillin dhe Parlamentin Evropian që të lëvizin përpara me propozimin tonë. Unë vërtetë shpresoj se jemi shumë pranë një regjimi pa viza për të gjithë rajonin, i cili do të vendoset shumë shpejt", ka theksuar Dimitris Avramopoulos.



**MAJA KOCIJANÇIÇ**

"Federica Mogherini takon Hashim Thaçin, Ramush Haradinajn, Kadri Veselin dhe Behgjet Pacollin, si dhe delegacionin kosovar të dialogut që të diskutohet perspektiva për liberalizim të vizave dhe progresi në rrugën drejt BE-së".



## Macron: Serbia s'ka shanse për në BE pa zgjidhur çështjen e Kosovës

Emmanuel Macron, Presidenti i Francës, kërkon që çështja e Kosovës të zgjidhet para anëtarësimit të Serbisë në BE. Macron të martën i tha presidentit serb, Aleksandar Vuçiç gjatë takimit që dyshja e zhvilloi në Paris se Serbia "nuk do të hyjë automatikisht" në Bashkimin Evropian më 2025, datë kjo e përmendur më parë si e mundshme për anëtarësim, pasi fillimisht duhen përmbushur disa parakushte. "Nuk mendoj se duhet parë kjo datë si një kriter automatik", tha Macron gjatë konferencës së përbashkët për media me presidentin serb, Vuçiç në pallatin 'Elysee', raporton "LaLibre". "Nëse nuk bëhet asgjë në raport me ato që është dakorduar në agjendën e negociatave deri më 2025, Serbia nuk ka shanse për anëtarësim në BE", tha presidenti francez. "Nuk kemi të bëjmë këtu me plotësim të hapësirave me 'ticka' me një datë e të themi 'më 2025 do të hyjmë'", shtoi Macron. Nëntorin e vitit që lamë pas, presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker përmendi se anëtarësimi i Serbisë dhe i Malit të Zi mund të ndodhë më 2025. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, pas takimit me homologun e tij francez, tha se Serbia nuk do të ketë perspektivë evropianë nëse problemi i Kosovës mbetet i ngrirë, raporton "N1". "Nëse konflikti i Kosovës mbetet i ngrirë, të jeni të sigurt se nuk do të ketë perspektivë evropiane, të jeni të sigurt se investimet do të bien", tha Vuçiç para reporterëve serbë në Paris, pas takimit me presidentin francez, Emmanuel Macron. Ai tha se Serbia do ta ketë përkrahjen e Macronit në gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi për Kosovën, duke shtuar se shpreson që ta ketë të njëjtën edhe nga Kancelarja gjermane, Angela Merkel. "Në atë rast ka pak shpresë", tha ai.

Presidenti i SHBA-ve: Njerëzit malazezë janë agresivë, mund të plasë Lufta e Tretë Botërore

# Donald Trump, i detyruar të mbrojë Malin e Zi? "Kështu janë gjërat"

## *Kërcënoi aleatët e NATO-s, "dorëzohet" kreu amerikan*


Donald Trump në një intervistë për median amerikane

Donald Trump, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duket se e vuri në dyshim detyrimin e SHBA për të mbrojtur Malin e Zi në kuadrin e NATO-s. "Mali i Zi, - tha ai - ka njerëz shumë agresivë. Ata mund të bëhen agresivë dhe pastaj jemi në Luftën e Tretë Botërore". Presidenti i bëri komentet gjatë një intervistë me Tucker Carlson të rrjetit "Fox News", pasi u pyet se përse duhet që ushtarët amerikanë të shkojnë në Mal të Zi për ta mbrojtur atë vend nga një sulm i mundshëm. Presidenti Trump i ka kritikuar shpesh anëtarët e tjerë të NATO-s rreth kontributit të tyre financiar për aleancën, duke thënë se SHBA-të mbajnë pjesën më të madhe të barrës. NATO-ja, e themeluar në vitin 1949 për të frenuar kërcënimin ushtarak të Bashkimit Sovjetik, mbështetet në epërsinë ushtarake të Shteteve të Bashkuara për t'u përballur me një mori kërcënimesh në kufijtë e Evropës, duke përfshirë Rusinë. Angazhimi për mbrojtje reciproke është shtylla e aleancës së NATO-s. Biseda Carlson-Trump në "Fox News".

**Carlson:**
Përse duhet që djali im të shkojë në Mal të Zi për ta mbrojtur atë nga sulmi? Përse të jetë kështu?

**Trump:**
E kuptoj çfarë po thoni. Unë kam shtruar të njëjtën pyetje. Mali i Zi është një vend i vogël me njerëz shumë të fortë.

**Carlson:**
Po. Unë nuk jam kundër Malit të Zi ose Shqipërisë.

**Trump:**
Jo, por meqë ra fjala, ata janë njerëz shumë të fortë. Ata kanë njerëz shumë agresivë. Mund të bëhen agresivë dhe... urime jemi pastaj në Luftën e Tretë Botërore. Unë e kuptoj këtë, por kështu janë ndërtuar gjërat.

> **DONALD TRUMP**
> "E kuptoj çfarë po thoni. Unë kam shtruar të njëjtën pyetje. Mali i Zi është një vend i vogël me njerëz shumë të fortë. Ata kanë njerëz shumë agresivë. Mund të bëhen agresivë dhe… urime, pastaj jemi në Luftën e Tretë Botërore. Unë e kuptoj këtë, por kështu janë ndërtuar gjërat", ka thënë Trump.

Ndërkohë që në takimin e bërë disa ditë më parë në Helsinki, presidenti Donald Trump tha se kishte ndërmend të kundërtën, kur deklaroi se ai nuk kuptonte se përse Rusia duhet të ndërhynte në zgjedhjet amerikane të vitit 2016. Ai u deklaroi gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë të martën se ai kishte ndërmend të thoshte se nuk shihte arsye se përse Rusia të mos ishte përgjegjëse. Ai tha gjithashtu se e pranonte përfundimin e nxjerrë nga komuniteti amerikan i zbulimit se Rusia ndërhyri në zgjedhje, por mohoi që fushata e tij të kishte bashkëpunuar fshehurazi në këtë përpjekje. Presidenti Trump i bëri komentet një ditë pas kthimit në SHBA, ku u kritikua thuajse nga të gjithë lidhur me ato që tha në konferencën e shtypit të mbajtur në Helsinki në krah të presidentit rus Vladimir Putin. Vetë presidenti Putin tha se kishte qenë dëshira e tij që Trump ta fitonte garën kundër demokrates Hillary Clinton. Në Helsinki, Presidenti Trump nuk e dënoi aspak ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhje dhe nuk pranoi të thoshte se ai u besonte agjencive amerikane të inteligjencës dhe jo mohimeve të Rusisë për ndërhyrjen. Ndërkohë, në komentet për gazetarët të martën, udhëheqësi republikan i Senatit, Mitch Mçonnell e quajti NATO-n "aleancën më të rëndësishme ushtarake në histori". Mçonnell tha: "Vendet evropiane janë miqtë tanë, rusët nuk janë". Senatori Mçonnell tha gjithashtu se e kishte ekzistojnë "prova të padiskutueshme", që Rusia u përpoq të ndikojë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Ai tha se Senati e kupton "kërcënimin e Rusisë" dhe kjo është "një pikëpamje e përhapur në Senatin e Shteteve të Bashkuara midis anëtarëve të të dyja partive". Komentet e zotit Mçonnell u bënë vetëm pak minuta para se Presidenti Trump të fliste në Shtëpinë e Bardhë. Synimi i senatorit ishte mesa duket t'i dërgonte një mesazh të qartë si Presidentit Trump, ashtu edhe evropianëve. Kryetari republikan i Dhomës së Përfaqësuesve, Paul Ryan, duke iu referuar komenteve të zotit Trump në Helsinki, tha: "Le të jemi shumë të qartë, Rusia ndërhyri në zgjedhjet tona. Ne e dimë se ata ndërhyjnë në zgjedhjet tona dhe kemi miratuar sanksione për Rusinë". Në takimin e nivelit të lartë në Helsinki, presidenti Trump u duk se favorizoi mohimin e bërë nga Presidenti Putin për ndërhyrjen ruse, në vend që të mbështeste vlerësimin e agjencive amerikane të zbulimit se Rusia në fakt u përpoq të ndërhyjë. Kritikët e akuzuan Presidentin amerikan, Donald Trump për një veprim të paprecedentë, duke i dhënë mbështetje presidentit rus kundër agjencive amerikane, të cilat kanë dalë në përfundimin se Moska ka ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara. Republikanët e Kongresit, me disa përjashtime, i shmangën kritikat e drejtpërdrejta ndaj Trump. Disa prej tyre i dolën në mbrojtje qëndrimit të tij kundër Prokurorit të Posaçëm, që po heton nëse ndërhyrja e Rusisë ndihmoi Trump të fitojë zgjedhjet. Komentet e Presidentit Donald Trump që fajësonin të dyja vendet për ndërhyrjen e Rusisë në procesin zgjedhor në Shtetet e Bashkuara shkaktuan reagimeve të ashpra, veçanërisht të demokratëve. "Është një veprim i pamenduar, i rrezikshëm dhe dobët që Presidenti i Shteteve të Bashkuara të mbështesë Presidentin Putin kundër autoriteteve amerikane të zbatimit të ligjit, zyrtarëve të mbrojtjes, agjencive amerikane të zbulimit", tha Chuck Schumer, udhëheqësi i pakicës në Senat. Sipas disa analistëve dhe komentuesve mediatikë, presidenti Trump nuk ia doli të tregonte forcë. "Presidenti u tregua i përulur ndaj Vladimir Putinit, ai ishte i ndrojtur, nuk kritikoi asnjë prej veprimeve të Rusisë jashtë apo brenda vendit që kanë shkaktuar kaq shumë vështirësi në sytë e SHBA-ve për shumë vite", thotë Jeffrey Rathke i Qendrës për Studimeve Strategjike e Ndërkombëtare. Me pak përjashtime, republikanët i shmangën kritikat e hapura ndaj Trump. Disa u dolën në mbrojtje sulmeve të tij ndaj hetimit mbi ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhje. "Dyshimi mbi diçka, deri në momentin e shqyrtimit dhe verifikimit të saj është i arsyeshëm. Por me gjithë këtë, e përsëris: e shoh Putitin si dikë me të cilin duhet të përballemi, si dikë që padyshim është pjesë e një perandorie të vjetër, të ligë dhe që nuk i ka ndryshuar zakonet", thotë ligjvenësi republikan, Darrell Issa. Një nga senatorët e rëndësishëm republikan, John Mçain e quajti daljen e Presidentit Trump përkrah Vladimir Putinin një "gabim tragjik". Në një deklaratë me shkrim, senatori nga Arizona shkruante se Trump ka bërë një "zgjedhje të vetëdijshme për të mbështetur një tiran". Takimi i Trumpit me homologun e tij rus me qëllim pajtimi i dha fund një turi evropian gjatë të cilit presidenti amerikan kritikoi NATO-n dhe e quajti Bashkimin Evropian "armik". "Ai ofendoi dhe kërcënoi aleatët tanë të NATO-s. Ai kërkoi të prishë një proces zgjedhor në pritje në Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas u pozicionua me rusët", thotë Eric Swalwell, ligjvënës demokrat. Senatori i Floridës, Bill Nelson u bëri thirrje të dyja palëve në Kongres të bashkohen kundër rrezikut që paraqet për demokracinë amerikane Presidenti rus, Vladimir Putin, një ish-spiun sovjetik. "Shpresoj të bashkohemi së shpejti, të dyja palët për të mbrojtur veten dhe t'i bëjmë opozitë Putinit".

## SHKURT

### Turqi, babai masakron mjekun se fëmijës s'i ulej temperatura

Prindi i një fëmije që u paraqit në spital me temperaturë të lartë ka plagosur rëndë me mjete të forta një prej mjekëve të urgjencës, pas debatit që lindi mes tyre, sepse fëmijës nuk po i ulej temperatura. Gazeta turke "Sabah" raporton se ngjarja e rëndë ka ndodhur këtë të mërkurë në qytetin Sanliurfa, në Turqi. Gjatë mjekimit të fëmijës, mjeku Bahattin Ahmet Yalçin ka debatuar me babanë e pacientit me iniciale A.K. Në mes u fut personeli i sigurisë, që mundësoi nxjerrjen jashtë spitalit të të afërmit. Por A. K. raportohet se pasi hoqi një pllakë nga trotuari, u fut sërish në ambientet e spitalit duke e qëlluar me të në kokë mjekun me të cilin kishte debatuar më herët. Fotot e pllakës së thyer pas goditjes në kokë të mjekut dhe pamjet e Yalçin në gjak u shpërndanë gjerësisht në rrjetet sociale, në shenjë solidariteti me bluzat e bardha. Agjencia turke e lajmeve "AA" raportoi se mjeku iu nënshtrua një operacioni dhe vazhdon të mbetet në gjendje kritike për jetën, ndërsa policia arrestoi autorin. Ngjarja e rëndë është dënuar ashpër nga të gjitha shoqatat e mjekëve në Turqi.

### Shemben dy ndërtesa në Indi, 3 të vdekur dhe mbi 50 të zhdukur

Tre persona humbën jetën dhe 50 kanë mbetur të bllokuar, pas shembjes së dy ndërtesave në Nju Delhit në Indi. Një pallat në ndërtim u shemb, duke shkatërruar edhe një ndërtesë të vjetër banimi ngjitur me të. Shkak i shembjes së objektit në ndërtim dyshohet se ka qenë moszbatimi i rregullave të ndërtimit, një fenomen tepër i përhapur në Indi.

### SHBA, çadra shkakton horror në plazh

Në një plazh të Nju Xhersit në SHBA ka ndodhur një prej incidenteve më të pazakonta ndonjëherë. Teksa 67-vjeçarja nga Britania, Margaret Reynolds po merrte rreze në plazh nisi një erë e fuqishme dhe gjithçka rreth saj "fluturoi". Era e fortë kishte marrë me vete edhe një çadër, e cila u ngul në këmbën e turistes që filloi të ulërinte nga dhimbjet. Në vendngjarje mbërritën menjëherë ekipet e ndihmës së shpejtë, të cilët si të vetmen mënyrë për të shpëtuar gruan gjetën këputjen me prerëse hekuri të bishtit të çadrës dhe dërgimin e gruas në operacion. Reynolds u dërgua urgjentisht në spital ndërsa dëshmitarët okularë shpjeguan për median lokale tmerrin që shkaktoi era dhe çadra në plazh.

UJI, A JENI TË SIGURT QË HIDRATOHENI MJAFTUESHËM?

SUMMER pages
SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE
E enjte 19 Korrik 2018



BALERINA SHQIPTARE

## Me bikini dhe këmbët hapur, Klaudia Pepa "çmend" fansat



## Aurela Hoxha shfaqet shumë "hot" në plazh

BULEVARDI POLITIK



- Gruaja para Ramës: Dua t'ju përqafoj! Më bëtë gruan më të lumtur në botë
- Dibrani, Ramës: Me ardh e me i pa rrugët tona humb kali bashkë me samar
- "Rrofsh e qofsh Edi Rama", dhurata e kryeministrit për këngëtarin
- Ç'ndodhi në Komisionin e Jashtëm, deputeti i PD rrufit një kafe



Rrëfehet aktorja: Dashuria për aktrimin, si rigjenerim i shpirtit

# ENXHI ÇUKU:

## Në Shqipëri është e vështirë të jesh artiste

*"Në përditshmërinë time jam selektive"*

## Rrëfehet aktorja: Dashuria për aktrimin, si rigjenerim i shpirtit

# Enxhi Çuku:

# Në Shqipëri është e vështirë të jesh artiste

### *"Në përditshmërinë time jam selektive"*



Egla Xhemali

*Sa herë që kujtojmë Enxhi Çukun na vjen ndërmend ko media romantike "Femrat" me Ermal Mamaqin. Që prej asaj kohe, bukuroshja është bërë pjesë jo vetëm e projekteve të shumta, por i është bashkuar edhe botës së radios dhe televizionit. Këtë herë aktorja vjen në një rrëfim për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" për pushimet verore, eksperiencën në skenë, rolet e ndryshme, për familjen si dhe për angazhimet e fundit që po ndërmerr. Kjo verë e ka gjetur të impenjuar aktoren. Enxhi e ka prekur skenën që kur ishte fare e vogël, për të mos u ndarë kurrë më prej saj. Përpos dashurisë së madhe që ka për aktrimin, Çuku na tregon se sa e vështirë është të jesh artiste në Shqipëri. Më tej na flet për raportin me familjarët dhe shoqërinë. Ajo pohon se është natyrë selektive. Së fundmi, Enxhi bën me dije se shumë shpejt do e shohim edhe në televizion.*

SI KA NISUR KJO VERË PËR ENXHIN?

*Shumë punë. (qesh) Jam duke u marrë me angazhimin në radio dhe me një projekt tjetër filmik. Por mund të them që nuk ua ndjej mungesën shumë pushimeve, pasi po bëj punën që dua.*

A I KENI PLANIFIKUAR PUSHIMET?

*Kam shijuar vetëm fundjavat, ku kam pasur paksa kohë për pushim. Nuk kam bërë plane për pushime afatgjata, pasi kohën e lirë e kam në varësi të ecurisë së punës. Ndoshta shtatori do më rezervojë një javë pushim. (qesh)*



ÇFARË E LIDH NJË AKTORE ME RADION?

*Asgjë dhe shumë. Në një farë mënyre t'i futesh në një rol sapo hyn në studio, i ofron diçka publikut, bën strukturën si do u drejtohesh, si do e përcjellësh informacionin dhe mëson dhe vetë shumë te kjo gjë. Për mua është një eksperiencë e bukur dhe po jap e po marr nga kjo përvojë.*

SI KA QENË EKSPERIENCA JUAJ E PARË NË SKENË?

*Hmm, në ekranin e vogël mund të themi shumë herët, që në moshën 15 vjeç me aktivitete të ndryshme. Ndërsa në ekranin e kinemasë, 17 vjeç.*

SA ËSHTË RRITUR ENXHI QË PREJ ASAJ KOHE?

*Shumë. Me kalimin e viteve, eksperienca të ndryshme, qoftë personale dhe profesionale, rritja vihet re dukshëm në mendimet dhe veprimet e mia. Mendoj se tani jam e aftë të zgjedh për veten time, duke e ditur se çfarë dua të bëj. Qoftë në punë, edhe në jetën private.*

AKTRIMI ËSHTË PËR JU MË SHUMË PASION APO PROFESION?

*Është dashuri për mua. Ka të ardhura, por shumë të pakta në Shqipëri, nisur kjo edhe nga prodhimtaria e paktë e vendit tonë. Kështu që më shumë i marr emocionin sesa fitimin, edhe pse sigurisht jam mundUar të caktoj dhe vlerat monetare të arsyeshme për mua.*

CILI ËSHTË AI ROL QË DO TË DONIT TA LUANIT PËRSËRI?

*Hmm, i dua shumë të gjitha rolet. Por, do doja të luaja rol të ri, magjia dhe bukuria qëndron te rolet e kaluara ashtu siç janë bërë.*

SA E VËSHTIRË ËSHTË TË JESH AKTORE NË SHQIPËRI?

*Është e vështirë, sepse s'ka punë. Nuk ka filma. Ata pak filma ose nuk do kenë buxhet, ose nuk do kenë skenar, kështu që digjen si mundësi. Unë kam vendosur më mirë të luaj pak filma, por mirë. Jam fokusuar te cilësia dhe jo te sasia.*

KENI MENDUAR NDONJËHERË TË HIQNI DORË NGA AKTRIMI?

*Asnjëherë.*

ÇFARË DI TË BËJË MË MIRË ENXHI?

*Shumë gjëra, ashtu siç nuk di të bëj edhe shumë gjëra të tjera. (qesh) Nuk do e thosha mendimin tim hapur se ku mendoj unë se jam e mirë. E urrej narcismin.*

JENI NATYRË SOLARE. A MOS NDOSHTA KA LIDHJE KJO ME PROFESIONIN TUAJ?

*S'besoj. Ambienti ose përplasja me padrejtësi, me njerëz jo të aftë, ose një botë që s'të kupton, të tjetërson. Natyra ime është e tillë, pasi jam rritur në një familje shumë të çiltër.*

SI JANË RAPORTET TUAJA ME FAMILJARËT? ME KË JENI MË E AFËRT?

*Shumë të mira. Janë edhe miqtë e mi përveçse familje. Më e lidhur jam me mamanë.*

DUKENI MJAFT E QETË. ÇFARË E NXEH ENXHIN?

*Mundohem ta ruaj qetësinë dhe kur nxehem. Më mërzisin edhe më nevrikosin njerëzit josuportues, pa ambicie. Unë jam e mendimit që bashkimi bën fuqinë dhe njëra dorë ndihmon tjetrën, por shumë njerëz nuk bashkëpunojnë dhe nuk duan të të shohin të arrish diçka. Duket sikur njerëzit duan vetëm të të zhysin dhe të të mbajnë në vend.*



SA MIQ KENI?

*Më pak se gishtat e një dore. Janë mikeshat e mia më të ngushta prej shumë vitesh.*

JENI SELEKTIVE APO PËRSHTATENI ME KËDO?

*Mund të përshtatem në ambiente ku më duhet, në mjedise pune, projekte. Por, në përditshmërinë time jam selektive.*

CILAT JANË PROJEKTET TUAJA PËR TË ARDHMEN?

*Kam disa projekte për të prezantuar sapo të mbarojë sezoni veror. Do të jetë premiera e filmit "Internim", që është bërë i ditur tashmë, ndërkohë një tjetër projekt filmik mund të jetë në plan. Por do të jem prezente edhe në televizion së shpejti.*

# Me bikini dhe këmbët hapur, Klaudia Pepa "çmend" fansat

Balerina shqiptare, Klaudia Pepa ka ndezur sërish rrjetin me postimin e saj të radhës. Klaudia shfaqet me bikini dhe tepër lozonjare duke shijuar një shihe birre. Ndërkohë fansat e saj nuk kanë kursyer aspak komentet nga më pozitive. Në mesin e tyre ka nga ata që kanë shfrenuar fantazinë me komentet e tyre nga më befasueset. Duket se këto postime të Klaudias shtojnë edhe më tepër temperaturat. Këtë herë balerina ka preferuar të qëndrojë indiferente ndaj reagimeve të fansave të saj.





# Xheni e BB9 'ndez' rrjetin me postimin e saj provokues

Ish-banorja e 'Big Brother' ka 'ndezur' rrjetin "Instagram" me postimin e saj provokues. Tanimë është sezon plazhi dhe postimet e rrjeteve sociale dominohen nga fotot me bikini. Këtë herë Xheni ka ndarë një foto mjaft të nxehtë teksa shfaqet duke marrë rreze dielli. Menjëherë pas këtij publikimi kanë vërshuar komentet pozitive ndaj saj. Pas ndarjes nga Benardi, Xheni ka preferuar të mos jetë shumë aktive në postimet e saj në rrjetet sociale.





# Aurela Hoxha shfaqet shumë "hot" në plazh

Ajo është nga modelet më të komentuara në Shqipëri. Aurela Hoxha mesa duket po i shijon pafund këto ditë të nxehta vere. Bukuroshja ka qenë mjaft aktive në rrjetin social "Instagram", ku së fundmi ka postuar një video ku duket mjaft provokuese me bikinit e zeza. Aurela pozon e qeshur teksa del nga deti. Reagimet në komente kanë qenë pozitive.



# Keisi Meidini lë pa fjalë, ja si duket modelja

Keisi Meidini është një nga pjesëtaret më të njohura të grupit "OTR". Bukuroshja duket mjaft tërheqëse teksa shijon ditët e pushimeve në plazh. Këto kohë postimet e modeles kanë qenë shumë të shpeshta. Së fundit, ajo ka ndarë me fansat e saj në "Instastory" një foto ku bie në sy gjoksi i zbuluar nga bikinit e zeza. Keisi ishte pjesë e këngës më të fundit që publikoi i ati, Sabiani, e cila ka vetëm pak kohë që ka dal në tregun muzikor.









# Uji, a jeni të sigurt që hidratoheni mjaftueshëm?

## *I nxehti i verës dhe ajri i kondicionuar mund të rrisin nevojën tonë për lëngje*

Kur bën shumë nxehtë, sigurisht që djersitim më shumë. Në verë më shumë se në çdo stinë tjetër kemi nevojë të marrim sasinë e duhur të lëngjeve për ta mbajtur organizmin tonë në ekuilibrin e duhur. Efekti i parë i hidratimit joadekuat është një ndjenjë e përgjithshme e lodhjes, e cila shpesh ngatërrohet me lodhjen e periudhës para pushimeve. Edhe pamja e lëkurës vuan nga një furnizim i pamjaftueshëm i lëngjeve: atëherë, le të përpiqemi të kuptojmë nëse hidratohemi siç duhet gjatë ditës dhe si ta rregullojmë këtë gjë.

**Etja** - Është mekanizmi fiziologjik që nëna natyrë ka parashikuar për të sinjalizuar se trupi ynë ka nevojë për ujë. Fatkeqësisht, ne jemi bërë më pak të ndjeshëm ndaj këtyre sinjaleve dhe shpesh nuk e kënaqim etjen tonë në mënyrë adekuate ose me lëngjet e duhura. Përgjigjja më e thjeshtë dhe më e dukshme, kur kemi etje, është të pimë një ose më shumë gota uji. Ideale do të ishte konsumimi i tij në temperaturë dhome, por në ditët e nxehta kur jemi në kërkim të një pije freskuese, ne preferojmë disa gllënjka të freskëta. Gjithashtu, edhe kjo është një nevojë fiziologjike: trupi ynë përpiqet në çdo mënyrë për të ulur temperaturën e brendshme. Le të shkojmë me të, por t'i rezistojmë tundimit për të gëlltitur pije me akull që mund të shkaktojnë ngatërrime të bezdisshme. Në përgjithësi, një person që gëzon shëndet të mirë duhet të marrë dy litra ujë në ditë (rreth 8 gota). Më mirë të pish nga pak dhe shpesh sesa të pish një shishe të plotë dhe pastaj të mos hidratohesh për orë të tëra.

**Çfarë të pini** - Duhet të shmangen edhe pijet e ëmbla dhe të gazuara: ata nuk e shuajnë etjen dhe për më tepër ato janë një bombë e vërtetë kalorish. Nëse duam një pije që ka "shije", le të zgjedhim një çaj të ftohtë, ose ujë të aromatizuar që ne, gjithashtu, mund ta përgatisim në shtëpi, duke lënë për katër ose pesë orë në një litër ujë disa fruta që neve na pëlqejnë ose disa gjethe nenexhik. Pija duhet të ruhet në frigorifer dhe të filtrohet përpara se të pihet. Mbahet rreth një ditë. Kur është shumë nxehtë, është më mirë të reduktoni edhe konsumin e pijeve alkoolike.

**Ujë duke ngrënë** - Mos harroni se frutat dhe perimet janë shumë të pasura me ujë: një sallatë e bukur e gjelbër, një supë perimesh që mund ta konsumojmë të ngrohtë apo të ftohtë, një ekstrakt ose një frut i centrifuguar janë mënyra të shkëlqyera për të kontribuar në balancën tonë të ujit dhe në të njëjtën kohë të rivendosim kripërat minerale që kemi humbur përmes djersitjes.



**Mënyra e jetesës** - Për të kuptuar se sa ujë kemi nevojë çdo ditë, duhet të marrim parasysh, gjithashtu, se si i kalojmë ditët tona. Nëse kalojmë shumë kohë jashtë, të ekspozuar ndaj nxehtësisë së klimës, ne natyrisht duhet të hidratohemi më shumë.

E njëjta gjë vlen edhe nëse bëjmë ushtrime fizike dhe merremi me sport. Nëse, nga ana tjetër, kalojmë shumë kohë në ambiente të mbyllura, në një mjedis me ajër të kondicionuar, ne kujtojmë se ftohja artificiale dehidraton shtresat sipërfaqësore të epidermës.

Nevojitet edhe më shumë kujdes nëse përdorni një ventilator: rrjedha e ajrit e gjeneruar nga pajisja ndihmon për të avulluar djersën, por nuk ul temperaturën e mjedisit: trupi ynë do të vazhdojë të djersitë, të ruajë termoregullimin e duhur dhe djersa do të zhduket përsëri. Prandaj, shpërndarja e lëngjeve është shumë e lartë dhe është e nevojshme të pini me bollëk. Është, gjithashtu, një masë e mirë për të shmangur drejtimin e fluksit të ajrit direkt te ne.

**Ndihma e parë për lëkurën** - Epiderma jonë është shumë e ndjeshme ndaj pabarazive të ujit. Për këtë, përveç hidratimit nga brenda, me një dietë të ekuilibruar dhe sasinë e duhur të ujit, ajo duhet të hidratohet me produkte specifike të dizajnuara për verën.

Në rutinën e bukurisë tuaj duhet të keni një vëmendje më të madhe ndaj hidratimit, duke aplikuar një krem hidratues me një cilësi të lehtë për fytyrën dhe dekoltenë, për t'u përdorur gjithmonë në mbrëmje dhe në mëngjes, dhe me një krem të mirë për trupin që duhet të përdoret çdo herë që laheni. Duke pasur parasysh se, në të nxehtin e verës, ju bëni dush çdo ditë, mos edhe më shumë, është më mirë të kufizoni përdorimin e sapunëve të shkumëzuar dhe të preferoni vajrat larës, më pak agresivë për lëkurën.

Kur ju bëni sport në natyrë, ose shpenzoni shumë orë në të nxehtë jashtë shtëpisë, mund ta freskoni lëkurën, duke e spërkatur atë disa herë në ditë me ujë termal. Nëse në mbrëmje vëmë re se lëkura e fytyrës është shumë e thatë, mund ta masazhojmë butësisht me disa pika të vajit të arganit, gjithashtu, të shkëlqyeshme për të hidratuar edhe flokët e thatë.

# Gruaja para Ramës: Dua t'ju përqafoj! Më bëtë gruan më të lumtur në botë

Kryeministri Edi Rama zhvilloi takimin e radhës në sallën e hartave në Kryeministri me koordinatorët e bashkëqeverisjes. Rama tha se shumë probleme që janë denoncuar në platformën për bashkëqeverisjen janë zgjidhur. Njëra nga qytetaret që ishte në takim, është përlotur para kryeministrit, teksa ka thënë se problemi i saj me hipotekat ka gjetur zgjidhje dhe se kjo gjë e bën të ndihet gruaja më e lumtur në botë. "Kam 8 vite që më është bërë padrejtësi nga hipoteka. Prona iu hoq burrit tim dhe iu dha vjehrrës. Ia morën. Ngelëm dyerve të hipotekës dhe me vuajtje e halle se kam lindur e madhe, kam dy vajza. Faleminderit shumë për këtë që bëtë! Donin të vinin dhe vajzat, dhe më thanë; mami të lutem bëj një fotografi me Edi Ramën. Dua të të përqafoj. Më keni bërë gruan më të lumtur në botë, njëherë kur kanë lindur fëmijët dhe sot", tha qytetarja Redi Kola.



# Dibrani, Ramës: Me ardh e me i pa rrugët tona humb kali bashkë me samar

Një tjetër qytetar i shprehu kryeministrit Edi Rama një shqetësim, që lidhej me mungesën e infrastrukturës rrugore. Agim Mura nga komuna Luzinjë në Dibër tha se rrugët në zonën ku ai jeton janë në një gjendje shumë të keqe. Rama ia ktheu përgjigjen dibranit duke i thënë se ky është një shqetësim real, që lidhet me administrimin nga komunat. "Zona ku jam unë kanë të gjithë nevojë për ndihmë ekonomike. Me ardh atje e me i pa rrugët tona, humb kali bashkë me samar. Kam ardhur për një të drejtë. Të drejtën kërkoj", - tha banori i Dibrës. "Shumë respekt për ju. Shqetësim real, jo vetëm në komunën tuaj, por në shumë komuna. Duhet adresuar në vijimësi nga shumë komuna. Ngarkesa e ish-komunave me personel kot është e patolerueshme", - tha z.Rama.






# "Rrofsh e qofsh Edi Rama", dhurata e kryeministrit për këngëtarin

Pjesëtari i "West Side Family", Roland Hysa me datën 17 korrik kishte ditëlindjen, ndërsa urimet dhe dhuratat nga të afërmit dhe miqtë kanë qenë të shumta. Por dhurata më e veçantë këngëtarit i është bërë nga kryeministri i vendit, Edi Rama. Në një postim në "Instagram", Landi ka zbuluar se ka marrë nga kryeministri një shishe verë. Kujtojmë se kryeministri Edi Rama ka kënduar së bashku me "West Side Family" këngën "Tirona" gjatë kohës kur ishte kreu i Bashkisë së Tiranës.




# Ç'ndodhi në Komisionin e Jashtëm, deputeti i PD rrufit një kafe

Seanca e djeshme në Komisionin e Politikave të Jashtme u fokusua tek çështja e negociatave me BE-në dhe tek bisedimet me Greqinë. Në komision sot u paraqit ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili iu përgjigj pyetjeve të deputetëve opozitarë për progresin në këtë çështje. Por përveç diskutimeve formale, në komisionet parlamentare të deputetëve shqiptarë ka gjithmonë detaje që s'duhen kaluar pa iu hedhur një sy. I tillë ishte edhe sot momenti kur ish-ministrja e Integrimit, Klajda Gjosha, po fliste në komision për negociatat, ndërkohë që demokrati Klevis Balliu porosit një kafe dhe ujë pa gaz.



DEBATI PUBLIK

# Për kontratën proteatër të forcave opozitare

Nga Aurel Plasari


Aurel Plasari

*Të premten artistët takojnë Vlahutin*

Në një moment ballafaqimi historik si ky, mes demokracisë shqiptare të rrezikuar dhe totalitarizmit të shfaqur, akti politik i radhës nga ana e forcave politike opozitare mbetet nënshkrimi i një kontrate të përbashkët Proteatër. Nga vizioni që ushqehet për një shoqëri demokratike do të kërkohej që:

Kontrata Proteatër e Forcave Opozitare të hartohet jo vetëm simpas parimit "inter partes", d.m.th. mes tyre vetë, por edhe në bazë të parimit "erga omnes", që do të thotë ndaj të gjithëve në kuptimin e zbatimit të një kontrate me vlerë të barabartë me regjistrim në një regjistër publik, duke filluar nga shoqatat, organizatat, grupimet dhe individët që vijojnë betejën për mbrojtjen e kompleksit shumëfish historik e kulturor, në të cilin funksionojnë aktualisht dy teatrot, ai Kombëtar dhe ai Eksperimental, dhe njëherësh për mbrojtjen e pronës publike në kërcënuar nga tjetërsimi politik;

Kontrata Proteatër e Forcave Opozitare të garantojë që, në momentin politik kur forcat opozitare t'i kenë së toku votat e duhura në Kuvendin e Shqipërisë, ta zhbëjnë (juridikisht ta bëjnë nul) ligjin 75-votësh të 5 korrikut 2018, të cilin e vlerësojnë abuziv dhe antikushtetues, si të hartuar e të miratuar në rrethana juridike pakushtetutshmërie, më konkretisht në rrethanat e një Republike pa Gjykatë Kushtetuese;

Kontrata Proteatër e Opozitës të garantojë publikun jo vetëm që prona publike e tjetërsuar nëpërmjet ligjit 75-votësh të 5 korrikut 2018 do t'i kthehet po publikut, por edhe që çdo ndërtim i kryer mbi të, në përfitim prej ligjit të dëftuar si antikushtetues, do të ndëshkohet duke u asgjësuar;




Kontrata Proteatër e Forcave Opozitare të garantojë publikun që çdo ndërtues, i cili do të ketë ndërmarrë aktin e shembjes së kompleksit shumëfish historik e kulturor, në të cilin funksionojnë aktualisht dy teatrot, ai Kombëtar dhe ai Eksperimental, do të detyrohet ta dëmshpërblejë shembjen e kryer në mënyrën më të përshtatshme legale, qoftë edhe duke u detyruar ta rindërtojë kompleksin e shembur prej tij.

Kontrata Proteatër e Forcave Opozitare të garantojë publikun që do ta përfshijë ndër përparësitë e tyre kthimin e statusit "Monu-

FILMI

## "TRACCE"/ ROLAND SEJKO: KUR SHEMBJA KËRCËNON TEATRIN

Këto ditë kur projektet për ta rishkruar – edhe një herë – qendrën e Tiranës janë kthyer në vëmendjen e qytetarëve dhe të politikës, merr aktualitet të veçantë edhe një film i Roland Sejkos ("Traçe") për historikun e ndërtimeve italiane në kryeqytet, i konceptuar si kombinim sa funksional, aq edhe elegant i një numri videosh dhe fotosh krejt ekskluzive nga "Istituto Luce" dhe AQSHF. Ardian Vehbiu e nis me këtë shënim në "Peizazhe të fjalës" ripublikimin e "Traçe-s".

"Autori pati mirësinë t'ua japë lexuesve dhe vizitorëve të kësaj faqeje, mundësinë për ta parë filmin, që përndryshe është shfaqur vetëm një herë, në Teatrin Kombëtar, gjatë eventeve kushtuar Arkitekturës Italiane në Shqipëri, në 2014. Do të shohim pra, të tendosur midis statikes së fotografisë dhe dinamikes së imazhit-video, shndërrimet e përsëritura të Tiranës, në për-



pjekje për t'iu përshtatur kohëve dhe rolit të saj të ripërkufizuar si kryeqytet më parë i një shteti të ri në Europë, e më pas i një province të re të një perandorie me ambicie megalomane; për t'i mbetur pastaj në dorë regjimit totalitar të Hoxhës", shton Vehbiu. Për të, shkatërrime dhe ndërtime, që sjellin së bashku kohë të ndryshme, në kërkim të një thelbi jashtëkohor, të cilin t'ia bashkëlidhim vetë emrit Tiranë dhe kuptimit që i japim. Vehbiu vëren se përjetimi i këtij filmi, që kalon nga notat nostalgjike në atmosferën enigmatike të një qyteti që pritej të ishte dhe që pastaj (tani?) nuk është më, le të shërbejë edhe për të reflektuar, sado pak, edhe për la condition urbaine, në kushtet kur Tiranën e kanë kapluar ethet e politikës, të pushtetit dhe të pasurimit; qoftë edhe vetëm për të pyetur se ç'imazhe do t'i lërë së ardhmes e sotmja kaq e trazuar e qytetit. Vetë Roland Sejko shënon se "shembja që kërcënon ndërtesën e Teatrit Kombëtar në Tiranë më bën të nxjerr nga pluhuri edhe këtë dokumentar të shkurtër mbi ndërtimet italiane në Shqipëri, i cili përpiqet të rrëfejë ndërtimin e më tej shpërfytyrimin apo shkatërrimin deri edhe me dinamit gjatë komunizmit, njësoj siç pritet të hidhet nesër në erë ndërtesa e teatrit". Sejko kujton se është edhe një ironi e kohëve "dokumentari është shfaqur për herë të parë në Tiranë pikërisht në sallën e Teatrit Kombëtar, i kthyer, të paktën për atë ditë, në origjinën e vet si kinoteatër".

## "QEVERIA SHEMB TEATRIN, POR NDIHMON LOJËRAT E FATIT!"

### *Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit: Tatimi i tyre duhej të shkonte për kulturën*

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka dalë dje me një deklaratë, ku vë në dukje se qeveria po diskuton këto ditë një projektligj që sjell disa ndryshime në paketën fiskale. "Ajo që bie në sy është se Neni 5 i këtij projektligji propozon një reduktim të barrës fiskale për industrinë e lojërave të fatit, që xhiron qindra miliona euro në vit, e cila tani duhet të paguaj taksa mbi fitimet dhe jo mbi xhiron, siç ka qenë deri më sot. Është ende e paqartë se sa i madh do të jetë efekti për buxhetin e shtetit, por kuptohet se ky ndryshim do të sjellë një zvogëlim të të ardhurave publike", thotë Aleanca. Sipas saj, në fillimet e veta, qeveria aktuale u zotua të reduktonte dhe të minimizonte efektet e lojërave të fatit në shoqëri, duke kufizuar numrin e pikave, distancën mes tyre dhe duke i tatuar më fort. "Të ardhurat shtesë të përftuara nga tatimi mbi lojërat e fatit u premtuan se do të shpenzoheshin për të ndihmuar artin, kulturën dhe edukimin në vend. Sot, asnjë prej këtyre pretimeve nuk na ndodhur. Rregullorja mbi vendndodhjen e lojërave të fatit shtyhet nga viti në vit, ndërsa taksat ndaj tyre reduktohen. Me këtë rast, duam t'ju kujtojmë së një argumentet kryesore për ndërtimin e Teatrit të ri nëpërmjet një Partneriteti Publik-Privat ka qenë mungesa e fondeve në buxhetin e shtetit. Ky projektligj tregon që ky pretendim nuk qëndron", nënvizon Aleanca. Ajo thekson se qeverisja është çështje prioritetesh. "Fonde dhe burime mund të gjenden për projekte nga më të ndryshmet, por vendimet e qeverisë duhet të përcaktojnë se cilat prej tyre janë më të nevojshmet. Të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit nga këto zvogëlime taksash mbi lojërat e fatit mund të financonin fare mirë godinën e re të Teatrit Kombëtar si dhe restaurimin e godinës ekzistuese për një periudhë 5-10 vjeçare. Sipas këtij projektligji, është e qartë se cilat fusha dhe industri kanë përparësi sipas qeverisë aktuale. Prioritet konsiderohet industria e lojërave të fatit dhe jo pasuria publike dhe kultura e vendit, të cilat mund të mbroheshin dhe financoheshin fare mirë nga taksat e munguara. Fonde ka, po nuk ka dëshirë për t'i përdorur ato", mbyllet deklarata.






ment Kulture" tok me restaurimin e dy teatrove, atij Kombëtar dhe atij Eksperimental, që funksionojnë sot në kompleksin e ish-Qarkut "Skanderbeg", duke tërhequr në një sipërmarrje të tillë përvojën dhe ekspertizën e arkitektëve dhe ekspertëve të monumenteve të kulturës më të mirë në vend.

Kontrata Proteatër e Forcave Opozitare t'i ofrojë publikut garancitë e respektimit të saj simpas parimit bazik "Pacta sunt servanda" ("agreements must be kep"), sikurse funksionon ai jo vetëm në të Drejtën ndërkombëtare, por edhe në të drejtën civile posaçërisht në marrëveshjet kontraktuale, madje edhe më përtej, duke qenë parimi në fjalë një nga gurët e themelit të besimit që një shoqëri vendos për veten.

Si i pari rast i një Kontrate të tillë në Republikën e Shqipërisë politikisht pluraliste, ajo do të shërbente edhe si mësimdhënie për të gjitha palët politike në qeverisjen e Republikës duke kujtuar që koncepti "res publica" qysh prej Romës së lashtë kishte jo vetëm kuptimin e "çështjes publike", por edhe atë të "pronës publike" posa që quheshin "res publica" edhe një urë, një rrugë etj.

Justifikimet e gjasshme ndaj një Kontrate Proteatër të Forcave Opozitare, kinse një akt i tillë mund të shkojë përkundër interesave elektoralë etj., hidhen poshtë nëpërmjet metodës eksperimentale, e cila përdoret sot edhe në shkencat politike, më shqip me anë të sprovës: e ashtuquajtura "Rilindje" ndëshkoi e shembi sa deshi dhe votat iu shtuan.

Ekspertë juridikë të Opozitës, që ajo i mban për "madhorë", do të kenë rastin të sqarojnë, nëpërmjet qëndrimit ndaj një Kontrate të tillë, nëse janë reale apo jo ndaj tyre akuzat që ata i kanë shërbyer e u shërbejnë jo partive ku militojnë, por fondacioneve të huaja private që tanimë e kanë futur reformimin e Shqipërisë në rrugë pa krye.

KUJTESA

# Kthimi i të humburve në familjet tona

*Firmoset marrëveshja mes qeverisë shqiptare dhe ICMP për identifikimin dhe gjetjen e të zhdukurve të diktaturës*

Nga Gentiana Sula*

Hidhet një hap i rëndësishëm duke ndërmarrë këtë angazhim qeveritar për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e eshtrave të të zhdukurve apo të humburve të diktaturës. Shteti po merr përgjegjsitë e veta. Po merr nga pak tipare më njerëzore. Rreth 6,000 qytetarë, të ekzekutuar me apo pa gjyq, ose të vdekur burgjeve, nuk mundën të ktheheshin në shtëpi, në mënyrën më çnjerëzore. Mes tyre ka figura të shquara dhe njerëz të thjeshtë. Në cilësinë e familjares së një personi të zhdukur prej vitit 1952 dëshmoj se prej disa dhjetëvjeçarësh jemi përpjekur të bëjmë diçka për eshtrat e gjyshit nuk munda ta njoh. Sulejman Mara vdiq në rrethana të paqarta dhe humbi në burgun e Burrelit, në moshën 44-vjeçare. Baba i 5 fëmijëve. Qytetar i respektuar në bashkësinë e tij. Emri i tij nuk figuronte si i humbur në librat e shtetit. Prokuroria e rrethit Burrel nuk hapi ndonjë proces për kërkimin e tij. Në përpjekje për të bërë diçka për t'i vënë në vend dinjitetin, mësova me dhimbje se vendvarrimet e tilla ishin shpesh të pashenjuara, apo edhe të tjetërsuara në ndërtesa apo ngrehina të tjera si psh., fushë sporti (rasti i Burrelit). Ishim pajtuar mbase me faktin se shteti s'kishte mjete për të bërë një kërkim të tillë në mënyrë efikase sepse analizat e ADN-së ishin të kushtueshme, por mosrespektimi i vendvarrimeve të njohura si të tilla më dukej shumë i rëndë. Ndihem kokulur që dinjiteti i tij sot është ende i nëpërkëmbur. Ndihem ende e dhunuar sot, ashtu si Aldo Terrusi, i biri i drejtorit të Bankës Italiane të viteve të pasluftës, i cili pati të njëjtin fat si im gjysh, në të njëjtin vend. Për këtë arsye, ende vazhdojmë përpjekjet prej njerëzish të lirë të kërkojmë që shteti të bëjë detyrat e veta. Sfida të tjera do të vijojnë me hapjen e këtij procesi, por si qytetare e këtij vendi demokratik është e rëndësishme për mua dhe më bën të ndihem më e lirë dhe e respektuar fakti që shoqëria dhe shteti shqiptar, më në fund e njohin këtë problematikë, e trajtojnë në disa plane dhe marrin përsipër të trajtojnë njerëzisht viktimën pa varr dhe pasardhësit e saj. Kurse në cilësinë e politikëbërëses publike, detyrën e mora në vitin 2014 kur mbaja detyrën e zv.ministres së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky pozicion më dha mundësinë të avancoja agjendën e vështirë për këtë proces.

Raportet e Komitetit të Zhdukjeve me Forcë të Kombeve të Bashkuara, për herë të parë në 2018 përmendin çështjen e të zhdukurve të komunizmit. Mes tyre, i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, të cilin e kryesoj që nga fillimi i 2017-ës. Përparësi dhe kujdes i posaçëm i është kushtuar nga ana e legjislatorit dhënies të së drejtës për akses, mbi bazë kërkese në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për personat e vdekur dhe të shpallur të zhdukur, si dhe vënia në dispozicion e dublikatave të tyre, duke përcaktuar rendin ligjor të personave që përfitojnë nga kjo e drejtë dhe të të afërmve të tyre, në funksion të qartësimit të fatit të të vdekurve apo të të zhdukurve, për rehabilitimin, për ruajtjen e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të zhdukurve. Për kërkesat e paraqitura nga gjykatat, prokuroritë ose Policia Gjyqësore, për efekt të një procedimi penal të regjistruar, Autoriteti kryen verifikimet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, dhe në çdo rast, vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi.


Gentiana Sula

### TË DENJË MES NJEREZVE

Numri i kërkesave që kanë të bëjnë me persona të zhdukur në AIDSSH e ka kaluar 40 dhe rritet ditë pas dite. Kjo lidhet me besimin në rritje të familjarëve të të zhdukurve për të drejtën e tyre njerëzore për të kërkuar vendprehjen e të ekzekutuarve pa gjyq, e të zhdukurve në rrethana të paqarta, traumë që familja e ka mbartur për vite të tëra dhe ka mbetur e patrajtuar. Shpreh nderimin tim më të lartë për familjarët e përkushtuar, si Nikolin Kurti, Hamza Kazazi, Vera Mborja, apo familjet Toto, Plaku, etj., që megjithëse gjatë këtyre viteve nuk ia kanë dalë, ende bëjnë detyrën e tyre humane të moshumbjes së shpresës dhe respektit ndaj familjarëve të tyre të ndjerë që janë ende të humbur. Një shembull i lartë i qëndresës dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor është ai i familjarëve të të ekzekutuarve pa gjyq me pretekstin e "bombës" në Ambasadën Sovjetike, familjet Shehu, Kaceli, Peshkëpia, Kasimati, etj., të cilët jo vetëm mundën t'i rikuperonin eshtrat e familjarëve, por kanë 25 vjet që ende synojnë kthimin e vendit të ekzekutimit në vend të kujtesës dhe vetëdijësimi. Si dhe mijëra familje që patën fatin e mirë të kenë mundësi përmes rrugëve private të bëjnë nderimet e tyre familjarëve të humbur në diktaturë.

### VENDVARRIMET E FSHEHTA

Me AIDSSH besojmë se çdo vendekzekutim dhe vendvarrim i fshehtë duhet të ruhet, shenjohet dhe të kthehet në vend ndërgjegjësimi. Autoriteti ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për përfshirje në projektligjin "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" të një pike ku të përfshihen si vende kujtese dhe vetëdijësimi vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste. Po ashtu, Autoriteti i është drejtuar me një propozim Këshillit Bashkiak të Tiranës për kthimin në vend të ndërgjegjes të vendvarrimit të fshehtë të viktimave të 26 shkurtit, në përkujtim të intelektualëve të ekzekutuar, të njohur si "grupi i bombës në Ambasadën Sovjetike".

Në planin strategjik të AIDSSH, kërkimi dhe trajtimi i rasteve të personave të zhdukur është një nga elementet e punës së institucionit. Po ashtu, në marrëveshjen me IIPP-në, mes të tjerash, bashkëpunimi për të zhdukurit përbën një seksion të veçantë. Të dyja palët angazhohen të bashkëpunojnë për referimin e të zhdukurve, identifikimin e secilit prej rasteve të gjetjes së tyre, pra një protokoll të përbashkët veprimi për të gjitha rastet e raportimit; krijimin e bazës së të dhënave me akses nga të dy institucionet me emrat e personave të pagjetur dhe vendvarrimet e vendekzekutimet, me synim përgatitjen e një regjistri të përbashkët me koordinatat e vendeve të ekzekutimit dhe varrimit të fshehtë, të raportuar nga familjarë apo të gjendur përmes kërkimit në arkiva. AIDSSH i ka kushtuar vëmendje e posaçme çdo rasti, gjatë trajtimit të dosjeve dhe dokumentacionit në shqyrtim, duke organizuar komunikime me individë, familjarë të të zhdukurve, të tilla si në aktivitetin e zhvilluar në përkujtim të Kampit të Tepelenës, më 30 gusht 2017, Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve.

Në këtë datë, Autoriteti përkujtoi varrezën e panjohur të fëmijëve dhe të zhdukurve të tjerë në Tepelenë dhe mbolli pemët e para të Memorialit të Fëmijëve që humbën jetën në kamp. Këtë vit, po planifikojmë përkujtimin e Ditës së të Zhdukurve, përmes një instalacioni masiv me mijëra qirinj në sheshin "Skënderbej" në Tiranë, për të nderuar shumë nga ata që sot nuk kanë një vend ku të prehen.

Hapat e ndërmarrë janë konkretë. Shoqëria e sotme - e cila mban peshën e të pathënave të së shkuarës, e asaj që ka mbetur pa zbuluar, pa dalë në dritë, e fateve të lëna në mes, e fëmijëve të rritur pa prindër që u zhdukën brenda natës, e pasardhësve që nuk identifikohen me të parët se u është tjetërsuar mundësia për ta bërë, - duket se është gati të përgjigjet dhe të marrë përgjegjësi.

** Kryetare e AIDSSH*

Opinioni *i* Ditës

# Konsolidimi i funksioneve të reja të pushtetit vendor

Dr. Sorina Koti

*(vijon nga faqja 1)*

... si një proces që do forcojë më tej menaxhimin dhe qeverisjen lokale.

Procesi i decentralizimit edhe pse ka vite që është hartuar, zbatimi i saj është penguar disa herë. Me fillimin e zbatimit të RAT supozohej që të mbyllej plotësisht edhe ky proces për pushtetin vendor. Si rezultat i decentralizimit dhe i rritjes së përgjegjësive për bashkitë, pritej që bashkitë të ishin më efektive në shpërndarjen e shërbimeve publike, duke përmirësuar jetën e qytetarëve, si dhe duke krijuar një klimë të mirë për biznesin, i cili supozohej të ishte aktori kryesor për nxitjen e investimeve dhe rritjen ekonomike rajonale. Por, a ka ndodhur realisht decentralizimi dhe konsolidimi i funksioneve të reja?

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015, bashkitë e reja duhet të konsolidonin fillimisht pasqyrat financiare të ish-komunave me bashkinë e re të madhe. Ky ishte një proces i ngadaltë dhe problematik. Ende ka probleme me inventarizimin dhe identifikimin e të gjitha aseteve dhe detyrimeve të njësive të mëparshme. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë dhe identifikimit fizik të aseteve, ky proces u transferua tek bashkitë e reja, ku kostoja e përfundimit të tij parashikohet të jetë e lartë. Detyrë në vazhdimësi e bashkive do të jetë identifikimi i vazhdueshëm i të gjitha aseteve dhe regjistrimi i plotë i tyre.




**Tabela 1. Transferta e kushtëzuar ndër vite**
**Burimi: financatvendore.al**

RAT u dha bashkive zyrtarisht edhe funksione të reja shtesë për menaxhimin e shërbimeve arsimore parauniversitare, qendrave shëndetësore, mbrojtje dhe menaxhimin pyjor, zhvillimin urban dhe social. Në pamje të parë, bashkive iu rritën kompetencat dhe pushteti qeverisës, sikundër u rritën edhe përgjegjësitë për shërbime karshi qytetarëve. Decentralizimi financiar dhe shtimi i kompetencave të bashkive u mirëprit dhe personalisht mbështes forcimin e këtyre funksioneve në një nivel të ri lokal. Por, besoj se problemi qëndron tek pamjaftueshmëria e burimeve financiare lokale, mungesa e burimeve njerëzore si dhe abuzimi politik që mund t'u bëhet punonjësve të administratës. Kështu që, kjo do kërkonte një vëmendje më të madhe nga pushteti qendror me kontrolle, trajnime dhe monitorime të zbatimit të funksioneve të reja, deri në pikën kur bashkitë të jenë të afta t'i menaxhojnë vetë, si nga ana financiare, edhe njerëzore. Sot, 3 vjet pas zbatimit të RAT, nuk kemi ende konsolidim të funksioneve shtesë dhe as vëmendje nga pushteti qendror. Zbatimi i reformës po i lihet fatit...

Këtë problem e tregon transferta e kushtëzuar me anë të luhatjeve të fondeve të ministrive përkatëse përkundrejt shërbimeve të ofruara nga pushteti vendor. Mungesat në aktet nënligjore dhe në zbatueshmërinë reale të reformës kanë futur në ngërç bashkitë, pasi transferimi i funksioneve të reja nuk është shoqëruar me rritjen e fondeve përkatëse. Tabela më poshtë tregon transfertën e kushtëzuar për vitet e fundit.

Nga sa më sipër, konstatojmë se transferta e kushtëzuar nuk ka qenë në nivelet e kërkuara nga bashkitë. Shifrat tregojnë se qeveria ka disbursuar më pak fonde gjatë tremujorit të parë të 2018-tës në krahasim me një vit më parë. Nga grafiku shohim se në vitet 2013-2014, kjo transfertë ka qenë më e lartë (atëherë kur bashkitë nuk kishin funksione të reja shtesë) sesa këtë vit, kur supozohej se bashkitë do forconin dhe konsolidonin funksionet e tyre. Administrata e bashkive ende ka paqartësi sesi do kryhet shpërndarja dhe përdorimi i transfertës së kushtëzuar.

Shërbimet e reja që po ofrohen nga bashkia kërkojnë më shumë fonde si dhe mbështetje financiare nga ana e qeverisë. Qeveria duhet të përfundojë procesin e decentralizimit të plotë financiar dhe të alokojë nëpërmjet ministrive të gjitha fondet e nevojshme për ato shërbime që do kryejnë bashkitë (dikur nën varësi të ministrive), në mënyrë që bashkitë të kenë fondet e mjaftueshme për të siguruar shërbime cilësore dhe të prekshme nga të gjithë qytetarët.

Ky proces duket ende i largët jo vetëm për shkak të një buxheti të brishtë qeveritar, por edhe për arsye të një rritjeje në vazhdim të borxhit publik. Konsolidimi i funksioneve të reja bashkiake do jetë një proces i dhimbshëm për qytetarët dhe për vetë bashkitë, të cilat do e mbyllin mandatin e parë të aplikimit të RAT pa eficencën dhe rezultatet e parashikuara.



Opinioni i Ditës

# Amerika, Gjermania dhe ndarja ideologjike

"Zëri i Amerikës"

*(vijon nga faqja 1)*

... kanë qenë një fatkeqësi për Evropën.

"Angela dikur ishte një 'superstar', deri në momentin kur lejoi miliona njerëz të vinin në Gjermani", tha ai. Komentet e tij pasojnë ato që ai bëri në takimin e nivelit të lartë javën e kaluar, ku kritikoi Gjermaninë se mbështetet në furnizimin me gaz të lirë nga Rusia, duke shpresuar që Amerika të vazhdojë të ndihmojë mbrojtjen e Evropës.

Kritikat e zotit Trump kanë shkaktuar habi në rritje në Berlin, por jo kudo në qarqet evropiane. Kritikat e presidentit amerikan kanë gjetur mbështetje tek disa nga fqinjët e afërt të Gjermanisë.

Ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, e përshkroi të dielën administratën "Trump" si kundërshtare, duke thënë se Gjermania mund "të mos mbështetet më te Shtëpia e Bardhë". Atlanticistët në Europë shqetësohen se ai mund të ketë të drejtë, duke pohuar se përçarja në rritje midis Berlinit dhe Uashingtonit është një kërcënim shtesë për marrëdhëniet e tensionuara transatlantike.

"Ajo kërcënon jo vetëm aleancën e Atlantikut, por vetë Perëndimin", argumentonte komentatori britanik Daniel Johnson në gazetën "Britain's Times".

**NACIONALISTË POPULISTË**

Por ekziston një miratim i heshtur ndaj kritikave të presidentit Trump në adresë të Gjermanisë nga nacionalistët populistë të Evropës. Ata e shohin veten si kapitenët ideologjikë të zotit Trump, duke favorizuar një kufizim të multilateralizmit, siç bën ai, për të cilin ata thonë se po dëmton të drejtat sovrane të shteteve.

Ndërkohë që disa populistë - veçanërisht polakët - kanë dyshimet e tyre rreth sinjaleve të presidentit të SHBA ndaj Vladimir Putinit të Rusisë. Ata gjithashtu kanë problemet e tyre me zonjën Merkel dhe nuk janë treguar veçanërisht të gatshëm për ta mbrojtur atë përballë kritikave amerikane. Ata po u bëjnë jehonë të njëjtave ankesa ndaj Gjermanisë.

Ndërsa pjesa më e madhe e mbulimit mediatik të samitit të NATO-s u përqendrua te ndarjet amerikano-evropiane mbi nivelin e shpenzimeve të mbrojtjes dhe gatishmërisë së dobët luftarake të forcave evropiane, disa diplomatë thonë se përçarja në rritje midis Gjermanisë dhe fqinjëve të saj të afërt është çdo po aq serioze sa ajo midis Presidentit Trump dhe Evropës si një e tërë.

Sipas analistëve, të dyja janë të lidhura me faktin që zoti Trump u shton guximin populistëve në Evropë dhe anasjellas. Këtë javë, kreu i partisë Lega të Italisë, Matteo Salvini, vlerësoi takimin e nivelit të lartë Trump-Putin, duke thënë se samiti i Helsinkit ishte një "fillim i mrekullueshëm".

Me përjashtim të qeverisë polake, udhëheqësit populistë të Evropës Qendrore favorizojnë heqjen e sanksioneve ndaj Rusisë të imponuara nga Perëndimi pas aneksimit të Krimesë nga Kremlini në vitin 2014. Kjo është vetëm njëra nga mosmarrëveshjet midis Gjermanisë dhe populistëve, të cilët janë duke u përpjekur të krijojnë një aleancë të re euroskeptike në Bruksel për të rritur fuqinë e tyre të kufizuar në bllok dhe për të kundërshtuar dominimin gjermano-francez.

Ata kanë mosmarrëveshje lidhur me të ardhmen e Bashkimit Evropian dhe e akuzojnë Berlinin se po përdor peshën e tij ekonomike duke i margjinalizuar ata, kur bëhet fjalë për vendimmarrjen dhe administrimin ekonomik brenda Bashkimit Evropian. Mosmarrëveshjet i kanë çuar marrëdhëniet midis shteteve të Vishegradit: Polonisë, Republikës Çeke, Sllovakisë dhe Hungarisë në një nivel edhe më të ulët. Ndërkaq, marrëdhëniet midis Gjermanisë së Merkelit dhe Austrisë, të udhëhequr nga populisti 32-vjeçar Sebastian Kurz, janë bërë gjithashtu të tendosura.

**NDARJA IDEOLOGJIKE**

Zyrtarët dhe analistët gjermanë asnjëherë nuk kanë pritur që Trump dhe Merkel të kenë marrëdhënie të mira mes tyre. Ajo është tepër e disiplinuar dhe e duruar, favorizon vazhdimësinë dhe parashikueshmërinë. Ajo duket qartë që është e zhgënjyer nga shpërfillja që zoti Trump u bën mirësjelljeve diplomatike. Por prapa konfrontimit qëndron një ndarje ideologjike.

Më shumë se një vit më parë, analistët Ulrike Esther Franke dhe Mark Leonard të Këshillit Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë parashikuan se Gjermania do të paraqitej një ditë si "armiku kryesor" nga administrata "Trump" për shkak të suficitit tregtar gjerman me SHBA-të, si dhe të fushatës së Merkelit për globalizimin dhe tregtinë e lirë apo të respektimit prej saj të multilateralizmit.

Ata vinin gjithashtu në dukje: "Ideologët e së djathtës alternative në qarqet e zotit Trump e urrejnë Gjermaninë për politikën e saj të refugjatëve", të cilën ata e shohin si "tradhti ndaj themelit judeo-kristian të Evropës".

Kjo pikëpamje ndahet nga udhëheqësi hungarez Viktor Orban, i cili i ka cilësuar azilkërkuesit myslimanë si "pushtues myslimanë".

Më parë këtë vit, ministri i tij i Jashtëm, Peter Szijjarto, gjatë një vizite në Uashington vuri në dukje në një intervistë se, "disa vende të Evropës Perëndimore do të donin të hynin në një fazë që mund të përshkruhet më mirë si 'paskrishtere dhe paskombëtare'. Por ne nuk duam atë. ...Ju e dini, Evropa duhet të jetë një kontinent i krishterë".

Sfida populiste në Evropë ka marrë inkurajimin e hapur të administratës "Trump" - nga kritikat e shpeshta të Presidentit të SHBA për politikat e migrimit të favorizuara nga kancelarja Merkel dhe Brukseli, e deri te një deklaratë e muajit qershor nga ambasadori i SHBA-ve në Gjermani, Richard Grenell. Ai tha se e sheh misionin e tij si fuqizimin e populistëve në Evropë dhe fraksioneve politike, që janë në harmoni me Uashingtonin e Presidentit Trump.



## HOROSKOPI

### DASHI

Suksesi duket se është shumë afër jush. Disa marrëveshje për prona do t'ju sjellin shumë fitim. Sjellja juaj naive do të luajë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e disa problemeve familjare. Mund të realizoni një udhëtim që do t'ju sjellë lidhje romantike.

### DEMI

Do të keni tension për shkak të disa çështjeve ligjore. Mos shpenzoni shumë për t'u bërë përshtypje të tjerëve. Do të ndiheni të irrituar për shkak të disa njerëzve rreth jush, por do të takoheni me një mik që ju dëgjon, kujdeset dhe ju mirëkupton.

### BINJAKET

Largoni mendimet e këqija, sepse nuk ju ndikojnë aspak mirë në shëndetin tuaj. Financat e pasigurta do t'ju shkaktojnë stres. Dilni me shoqërinë sepse do t'ju ndihmojë shumë për t'u ndjerë i/e kënaqur. Zgjidhini sot mosmarrëveshjet, përndryshe nesër do të jetë shumë vonë.

### GAFORJA

Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme sportive do t'ju ndihmojë të kompensoni energjinë e humbur. Marrëdhëniet e reja romantike do të zgjasin shumë. Marrëdhëniet personale do t'i keni nën kontroll. Shmangni shoqërimin me njerëz që cenojnë reputacionin tuaj. Sa u përket marrëdhënieve romantike, do të jetë dita juaj me fat.

### LUANI

Bëni shumë kujdes gjatë punëve në shtëpi, sepse mund t'iu krijohen probleme. Shpenzimet e papritura mund t'ju shkaktojnë dëme financiare. Shmangni zënkat dhe konfrontimet. Shmangni një hap të nxituar në dashuri.

### VIRGJERESHA

Duhet të relaksoheni dhe të gjeni lumturinë mes miqve të ngushtë dhe anëtarëve të familjes. Jetoni momentin dhe shpenzoni sa më shumë kohë për t'u argëtuar. Bëni të mundur që familjarët tuaj ta kuptojnë që ju kujdeseni për ta. Tregoni durim dhe zgjuarsi kur përballeni me kolegët në punë

### PESHORJA

Stresi mund t'ju shkaktojë gjendje jo të mirë shëndetësore. Përpiquni të mos i ofendoni të tjerët në shtëpi dhe ndihmoni familjarët. Sa i përket marrëdhënies në çift, do të jetë një ditë e bukur. Temperamenti juaj do t'ju vërë në disa situata të vështira në punë, por përpiquni të qetësoheni.

### AKREPI

Buzëqeshja është zgjidhja më e mirë e problemeve tuaja. Do të keni një ditë të mbushur plot me energji. Sot do ndjeni mungesë dashurie në jetën tuaj. Mos u shqetësoni, gjithçka ndryshon me kalimin e kohës, kështu do të ndodhë edhe me jetën tuaj romantike.

### SHIGJETARI

Ju do të fitoni një shumë të mirë parash sot nëse i luani letrat mirë. Kujdesuni për shëndetin e prindërve tuaj, pasi neglizhenca juaj mund të ndikojë tek ata. Lidhja juaj e dashurisë mund të këtë luhatje për shkak të orarit të ngjeshur në punë.

### BRICJAPI

Sot është një ditë e mirë për të ndjekur besimin tuaj. Investoni para për pronat e paluajtshme. Do të kaloni një ditë të lodhshme me fëmijët. Mos u tregoni detyrues në marrëdhënien tuaj në çift. Aftësia juaj për të ndihmuar të tjerët do të t'ju sjellë vetëm respekt.

### UJORI

Ju duhet të lini pas tensionin. Të gjitha investimet duhet të bëhen me kujdes dhe me konsultimin e duhur për të shmangur humbjet e panevojshme. Një romancë e re është e sigurt, për disa jeta do të lulëzohet nga dashuria. Shtyni projektet dhe shpenzimet e reja.

### PESHQIT

Elasticiteti dhe kuraja juaj do të rrisin fuqinë e aftësive mendore. Përdorini këto dy aftësi për të mbajtur situatat nën kontroll. Një marrëveshje e re financiare do të finalizohet dhe do t'ju sjellë të ardhura të konsiderueshme. Etja për njohuri do t'ju ndihmojë të bëni miq të rinj.

E enjte 19 Korrik 2018 GAZETA SHQIPTARE

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

# Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

## *Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Korçë. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitet e kërkuesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera




## KORÇË

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 368 | KORCE | | | | | |
| 380 | KORCE | SOKRAT | | MANO | | |
| 371 | KORCE | SERVET | | LARI | | |
| 372 | KORCE | ZINI | | TERROLLI | | |
| 375 | KORCE | IBRAHIM | | DIKOLLI | | |
| 393 | KORCE | VERGJINI | | BELURI | | |
| | KORCE | VERGJINI | | BELURI | | |
| 391 | KORCE | Muhamet | | BEQIRI | | |
| 385 | KORCE | SKENDER | | MULLALLI | | |
| 381 | KORCE | AFERDITA | | MANKOLLI | 468 | |
| 382 | KORCE | DHIMITER | | KACADANI | | |
| 383 | KORCE | KRISTAQ | | GJATA | | |
| 384 | KORCE | ALI | | MULLALLI | | |
| 386 | KORCE | SELAJDIN | | CENOLLI | | |
| 387 | KORCE | KOLI | | NIKOLLA | | |
| 388 | KORCE | SYRJA | | SHTYLLA | | |
| 389 | KORCE | GANI | | FASHO | | |
| 390 | KORCE | QERIME | | OGRENI | | |
| 392 | KORCE | AJREDIN | | MEHMETLLARI | | |
| 394 | KORCE | PALI | | JORGJI | | |
| 395 | KORCE | MEROPI | | KOLE | 425 | |
| 405 | KORCE | ISA | VESEL | ÇALLO | 1000 | |
| 406 | KORCE | ABIL | NJAZI | VILA | 10119 | |
| 397 | KORCE | ALIJE | ALI | GORA | 10680 | |
| 410 | KORCE | THIMI | | BOJDANI | 860 | |
| 404 | KORCE | KICO | | KOLI | 3000 | |
| | KORCE | KICO | | KOLI | REZIM KERKESE | |
| 408 | KORCE | SELAJDIN | | BEQIRAJ | 1920 | |
| 399 | KORCE | PETRO | NIKOLLA | PELESHI | 5300 | |
| 396 | KORCE | SELAMI | | PASHA | 500 | |
| 398 | KORCE | HATIXHE | | GORA | 10059 | |
| 400 | KORCE | NOVRUZ | IBRAHIM | KULLA | 4935 | |
| 401 | KORCE | IBRAHIM | ALI | ÇORBAXHIU | 3988 | |
| 403 | KORCE | KUJTIM | | QERIMI | 8503 | |
| | KORCE | KUJTIM | | QERIMI | 1212 | |
| 407 | KORCE | SHEFIKO | | BEQIRAJ | 1920 | |
| 409 | KORCE | VILERMINI | | NIKA | 9000 | |
| 1042 | Korçe | Ijonel | | Nasto | 7550 | Vertetim kadastral harte e sek. Urban |
| 1068 | Korçe | Agron | | Meçe | 7740 | Vertetim kadastral harte e sek. Urban |
| 1064 | Korçe | Muharrem | | Keçi | 1038 | Vertetim kadastral harte e sek. Urban |
| 1045 | Korçe | Merjeme | | Cenolli | | F Harte e sektorit urban |
| 1036 | Korçe | Fidarije | | Babani | 3805 | F - 1200 ; Vertetim kadastral; Harte e sek. Urb |
| 1037 | Korçe | Muhamer | | Hoxhallari | 8050 | Vertetim kadastral harte e sek. Urban |
| 1035 | Korçe | Hamit | | Riza | | Vertetim kadastral; F sip 300 ; Harte e sek urb |
| 1067 | Korçe | Xhelal | | Dedelli | 1392/21.2.97 | Vertetim kadastral |
| 1032 | Korçe | Engjell | | Gjinollari | 12683 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1055 | Korçe | Rami | | Lazellari | | |
| 1057 | Korçe | Mustafa | | Seit | | |
| 1058 | Korçe | Nasibi | | Agolli | | F; Harte sek. Urb |
| 1051 | Korçe | Hekuran | | Bashllari | 700 ( e dr parablerje objekti) ne rast mos privatizimi komp=700 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1048 | Korçe | Shefqet | | Meçollari | 2704 (parablerje 364 ) | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1046 | Korçe | Viktor | | Xhelati | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1066 | Korçe | Teki | | Kocibelli | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1050 | Korçe | Urma | | Selimllari | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1062 | Korçe | Vanthi | | Çuti | Te mos miratohet kerkesa per njohje pronesie per sip 6454 kjo sip eshte trajtuar me 2 vendime | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1044 | Korçe | Muhamet | | Xhaferi | 3800 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1041 | Korçe | Novruz | | Pino | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1039 | Korçe | Mestan | | Azisllari | 4710 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1038 | Korçe | Panse | | Koprencka | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1031 | Korçe | Bashkim | | Xhepollari | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1070 | Korçe | Fiqirije | | Shkembi | 2493 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1033 | Korçe | Islam | | Gjinollari | 487 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1056 | Korçe | Zenel | | Mulla | Mos miratim kerkese | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1053 | Korçe | Zhaneta | | Harizi | 204 | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1047 | Korçe | Todi | | Çollaku | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1069 | Korçe | Myfit | | Guxholli | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1061 | Korçe | Erato | | Konomi | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1060 | Korçe | Valentina | | Duçi | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1059 | Korçe | Neim | | Panariti | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1052 | Korçe | Kristaq | | Pojanaku | | Vertetim kadastral; Harte sek. Urb |
| 1111 | Korçe | Agim | | Bacelli | 6460 | Me planvendoje te Keshillit te Rrethit Korce |
| 1112 | Korçe | Frosina | | Naçi | 5430 | Me planvendoje te Keshillit te Rrethit Korce |
| 1113 | Korçe | Demir | | Musollari | 2000 | Me planvendoje te Keshillit te Rrethit Korce |
| 1114 | Korçe | Xhevit | | Meçolli | 3200 | Me planvendoje te Komunes Pojan |
| 1115 | Korçe | Fehmi | | Ymeti | 600 | Qender trajtuar vetem sip e tokes truall |
| 1116 | Korçe | Vasillo | | Ponari (Laço) | 500 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| 1117 | Korçe | Niko | | Çika | 500 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce te komunes Drenove |
| 1118 | Korçe | Ilmi | | Haxhi | 7520 | Me planvendosje te keshillit te rrethit |
| 1119 | Korçe | Ramadan | | Haxhi | 7520 | Me planvendosje te keshillit te rrethit |
| 1120 | Korçe | Nexhibe | | Haxhi | 7520 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| 1121 | Korçe | Rrapo | | Haxhi | 7520 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| | Korçe | Rrapo | | Haxhi | 760 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce; Nga dosja 1118-1121 behet fjale per pronat e te njejtit subjekt sipas dok |
| 1122 | Korçe | Lefter | | Tili | 1690 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| 1123 | Korçe | Dilaver | | Xhuti | 2000 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| 1124 | Korçe | Ferdinand | | Pengo | 550 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce; Diferenca 450 eshte ne pronesi te Kerkuesit |
| 1125 | Korçe | Lirika | | Gjika | 4454 | Trajtuar vetem toka truall |
| 1126 | Korçe | Mehmet | | Aliolli | 2200 | Me planvendosje te keshillit te rrethit Korce |
| 1128 | Korçe | Koçi | | Zisi | Mos miratim kerkese | Kerkesa eshte refuzuar pasi nuk eshte toke truall |
| 1129 | Korçe | Ridvan | | Sejdarasi | 3000 | Me planvendosje te komunes Voskop |
| 1130 | Korçe | Halim | | Çeliku | 2200 | Me planvendojse te kesh te rrethit korce |
| 1131 | Korçe | Fevri | | Bylykbashi | 554 | Diferenca mes 4646 eshte ne pronesi te kerkuesve |
| 1132 | Korçe | Llazi | | Xhelo | 2570 | Planvendosje nga komuna Pojan trajtuar vetem toka truall |

*(vijon)*


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al